



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 39 regjistër (JR)
Datë 15.10.2024

Nr. 13 i vendimit
Datë 05.02.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e enjte, datë 05.02.2026, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, nr. 39/2024 (JR), datë 15.10.2024, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 774, datë 14.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi përfaqësuesin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi¹, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 774, datë 14.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të

¹ Sipas autorizimit “Për përfaqësimin e çështjes në seancë publike”, nr. {***} prot., datë 20.01.2026.

rivlerësimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Petrit Vukaj dhe avokaten e tij, Romina Zano, të cilët përfundimisht kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”), dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë², me konstatimet se:
 - (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2. AKSIK-u, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 20.11.2023, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 17.11.2023, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj*.
 - 2.3. KLP-ja, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

² ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2018, ka përcjellë në Komision “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Petrit Vukaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”.

³ KLP-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.07.2023, ka përcjellë në Komision “Raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj”.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 774, datë 14.06.2024, në bazë të nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, dhe ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.*
4. Komisioni e ka mbështetur vendimin e mësipërm në konkluzionet e arritura mbi të tria kriteret e rivlerësimit, duke konkluduar për secilin prej tyre si vijon:

4.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë⁴: *“Në përfundim, referuar analizës financiare të rishikuar, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 1.459.774 lekë, konkretisht: (i) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 51.771 lekë për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2006; (ii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 559.230 lekë për blerjen e automjetit në periudhën prill – maj 2009; (iii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 713.857 lekë për ndërtimin e katit të parë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, në vitin 2010; (iv) mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në shumën (-) 134.916 lekë në vitin 2016, për kryerjen e shpenzimeve. Në përfundim, bazuar në konkluzionet më lart, për të gjitha pasuritë e deklaruar të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme, që lidhet me blerjen e pasurive, në momentin e krijimit të tyre, si dhe me kryerjen e shpenzimeve në vitet 2006, 2009, 2010 dhe 2016, e cila rezultoi në vlerën (-) 1.459.774 lekë, e shpërndarë ndër vite, nuk është e mjaftueshme për të cenuar nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 59, pika 1, shkronja ‘a’ e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion i trupit gjykues [...], vlerësohet nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit”.*

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës⁵: *“Nën këtë arsyetim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se nuk u provuan kushte apo rrethana, të cilat, në kuptim të kreut V të ligjit nr. 84/2016, apo specifikisht të nenit 38 të po këtij ligji, e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, dhe nuk mund të arrijë në një konkluzion tjetër, përveçse ai ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës ‘b’, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është çmuar edhe në raport me të dhënat negative të konfirmuara nga organet ligjzbatuese, që lidhen me verifikimin e kontrollit të figurës apo me mungesën e të dhënave të tjera përgjatë hetimit, lidhur me figurën e subjektit. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se, për sa kohë provat dhe rrethanat e kësaj çështjeje nuk ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, nuk evidentohen elemente të tillë të arsyeshëm, të konsiderueshëm apo të perceptueshëm, për t’i kualifikuar si cenim të besimit të publikut, sipas pikës 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.*

4.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale⁶: *“Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2,*

⁴ Paragrafët 39.7 - 40 të vendimit të Komisionit.

⁵ Paragrafët 41.37 - 41.38 i vendimit të Komisionit.

⁶ Paragrafi 48 i vendimit të Komisionit.

të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës 'a', të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet 'i aftë'".

4.4. Në vlerësimin tërësor të çështjes⁷, Komisioni çmoi se mangësitë e konstatuara në procesin e rivlerësimit për këtë subjekt, vlerësohen të pamjaftueshme për të arritur në konkludimin me masë penalizuese, për efekt të këtij procesi.

III. Shkaqet e ankimit

5. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim "Komisioneri Publik") ka paraqitur ankimin nr. {***} prot., datë 04.10.2024⁸, kundër vendimit nr. 774, datë 14.06.2024, të Komisionit.

5.1. Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, ka konstatuar se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 774, datë 14.06.2024, të Komisionit, dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë të cenusshëm në tërësinë e tij, dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur për shqyrtim nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim "Kolegji"). Bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 774, datë 14.06.2024, të Komisionit, ushtrohet në vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit.

5.2. Ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ka kërkuar që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 84/2016, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 774, datë 14.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Vukaj.*

6. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

⁷ Faqja 68 e vendimit të Komisionit.

⁸ Ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit C, pika 2 dhe nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 27.01.2026, 03.02.2026 dhe 05.02.2026.

9.1. Trupi gjykues i Kolegjit, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, dhe nenit 199/2 të Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore publike të datës 27.01.2026, vendosi kalimin procedural të palës Komisionerët Publikë te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

9.2. Në këtë seancë, në parashtrimet e tij përpara Kolegjit, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, deklaroi se u qëndron në parim shkaqeve të ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik kundër vendimit objekt ankimi, pasi parashtrihen si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi i Komisionit. Për rrjedhojë të sa më sipër, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme i qëndroi kërkimit të ankimit për ndryshimin e vendimit të Komisionit objekt ankimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

9.3. Në të njëjtën seancë, në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provës të akteve shkresore të depozituara së bashku me parashtrimet e tij⁹, pasi dëgjoi edhe

⁹ Subjekti i rivlerësimit paraqiti aktet:

- Akt vlerësimi tekniko-ekonomik i objektit “banesë 2-katëshe”, pa datë të shënuar në kopertinë, hartuar nga ing. F. P. dhe ing. E. B., me investitor Petrit Vukaj.
- Kërkesë për informacion, drejtuar servis “{***}”, Levan, Fier, nga z. Petrit Vukaj, lidhur me vlerën e motorëve “200D” dhe motorëve të kondicionerit, për mjetet e përdorura në vitet 2005 – 2007.
- Kthim përgjigjeje informative, datë 10.01.2026, nga z. A. Z., administrator i servis “{***}”, Levan, Fier, drejtuar z. Petrit Vukaj, lidhur me vlerat orientuese të pjesëve të përdorura të mjeteve motorike për periudhën 2005 – 2007.
- Procesverbal gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, seancat gjyqësore të datave 16.03.2021, 30.03.2021, 07.04.2021.
- Procesverbal gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, çështja nr. {***}, seancë gjyqësore e datës 16.03.2021, gjyqtare E. A., me objekt “Dërgimi i çështjes në gjyq”.
- Procesverbal gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, seancë gjyqësore e datës 07.04.2021, 08.04.2021, 13.04.2021.
- Akt ekspertimi autoteknik, datë 12.01.2026, hartuar nga ing. A. H., me objekt “analiza teknike mbi fuqinë (kw) të mjetit motorik, në raport me shpejtësinë maksimale të lëvizjes”.
- Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
- Kallëzim penal, me kallëzues Petrit Vukaj, datë 09.07.2024, së bashku me “Deklaratë për heqjen dorë nga gjykimi i procedimit penal”, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si dhe vendim i Drejtuesit të Prokurorisë për pranimin e deklarimit për heqje dorë.
- Vendim për dërgimin e çështjes për gjykim, nr. {***}, datë 29.05.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
- Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. {***}, të vitit 2022, përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
- Kërkesë e datës 01.02.2023, me kërkues M. M. (P.), dhe shkresa nr. {***} prot., datë 07.02.2023 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me lëndë: “Dërgohet për njoftim”, drejtuar av. K. C.

përfaqësuesin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme lidhur me këtë kërkesë, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të lejojë marrjen e tyre në cilësinë e provës, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar ato, në lidhje me tri kriteret e vlerësimit. Këto akte iu nënshtruan debatit gjyqësor dhe u vlerësuan nga Kolegji, në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.

9.4. Në lidhje me denoncimet e publikut¹⁰, në seancën gjyqësore publike të datës 27.01.2026, subjekti i rivlerësimit, në mbështetje edhe të akteve të paraqitura prej tij lidhur me këto denoncime, parashtroi se pretendimet e denoncuesve nuk qëndrojnë, duke i kërkuar Kolegjit të mos i marrë në konsideratë. Përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësim të shpjegimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, parashtroi se, lidhur me këto denoncime, nuk ka asnjë rrethanë që mund të jetë e vlefshme në këtë fazë të procesit, të tilla që do të kërkonin hetim të mëtejshëm administrativ. Në këto kushte, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vlerësoi se denoncimet e depozituara nga publiku nuk sjellin fakte dhe rrethana të cilat plotësojnë kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për të legjitimuar nevojën për hetime të mëtejshme.

9.5. Në seancën gjyqësore publike të datës 03.02.2026, trupi gjykues, bazuar në nenin 171/b të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të revokojë vendimin e ndërmjetëm të datës 27.01.2026 për mbylljen e hetimit gjyqësor, dhe ta riçelë sërish atë, me qëllim administrimin në cilësinë e provës, të akteve shkresore shtesë, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit¹¹.

9.6. Në të njëjtën seancë gjyqësore, në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deklaroi se, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në referencë të konkluzioneve të arritura për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në një vlerësim tërësor, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, ai kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit objekt ankimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

9.7. Në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit dhe avokatja e tij, pasi prapësuan pretendimet e Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit të Komisionit objekt ankimi, si një vendim i drejtë dhe i bazuar në prova e në ligj.

10. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi shkaqet e ngritura në ankimin e Komisionerit Publik, qëndrimin e përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në parashtrime, konkluzionet përfundimtare, si dhe analizoi e vlerësoi të gjitha provat që gjendeshin në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit, dhe ato të cilat u morën gjatë

- Shkresa nr. {***} prot., datë 07.11.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me lëndë: "Dërgohet për njoftim", drejtuar av. K. C., si dhe "Kërkesë" e datës 20.10.2022, me kërkues M. M. (P.), drejtuar prokurorit Petrit Vukaj.

¹⁰ Në Kolegj janë depozituar: denoncimi i z. I. H., i administruar në Kolegj me shkresat nr. {***} prot., datë 07.10.2025 dhe nr. {***} prot., datë 09.10.2025, dhe denoncimi i z. K. P., i administruar në Kolegj me shkresën nr. {***} prot., datë 04.11.2024.

¹¹ Subjekti i rivlerësimit, në vijim të aktivlerësimit tekniko-ekonomik të objektit "banesë 2-katëshe", paraqiti planimetritë teknike të katit përdhës dhe të katit të parë të këtij objekti, hartuar nga ekspertët, inxhinier F. P. dhe inxhinier E. B.

procesit gjyqësor në Kolegj e që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve, duke arsyetuar e konkluduar si vijon.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

11. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisioneri Publik, sipas të cilit: *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për pasurinë “banesë 2 kate”, ndodhur në lagjen “{***}”, Fier, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë:*

11.1. Lidhur me ndërtimin e katit të parë, me sipërfaqe 102 m², Komisioni ka arsyetuar në vendim se *mori në konsideratë se subjekti i rivlerësimit, në vitin 2009, ka ndërtuar sipërfaqen prej 57,6 m² dhe, në vitin 2010, sipërfaqen prej 44,4 m². Komisioni, referuar kostos mesatare të ndërtimit në qytetin e Fierit në vitet 2008 dhe 2009, kur subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar shtesën me sipërfaqe 57,6 m², ka përllogaritur vlerën për këtë sipërfaqe ndërtimore, në shumën 1.596.096 lekë (57,6 x 27.710 lekë/m²), ose vlerën 798.048 lekë për secilin vit. Ndërsa, për vitin 2010, kostoja e ndërtimit për sipërfaqen ndërtimore prej 44,4 m², është llogaritur në vlerën 1.257.452 lekë (44,4 x 28.321 lekë/m²). Në vijim, referuar arsyetimit lidhur me periudhën e ndërtimit, Komisioni kreu përllogaritjet për shumën e kostos së ndërtimit për vitet 2008, 2009, 2010, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,55%, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, nga ku ka rezultuar një kosto totale prej 2.609.570 lekësh. Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme për ndërtimin e banesës. Në kushtet që, në vitin 2009, subjekti ka blerë një pasuri të luajtshme “automjet”, Komisioni e kreu analizën financiare të vitit 2009 të ndarë në dy pjesë, referuar burimeve financiare të përdorura për secilin rast, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në shumën (-) 713.857 lekë për ndërtimin e katit të parë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve. Komisioni, pas analizimit të pretendimeve të subjektit, në raport me gjendjen faktike të kësaj çështjeje, vlerësoi se efekti financiar për ndërtimin e katit të parë deri në shtator të vitit 1994, duhet të çmohet në proporcion me disa fakte të qenësishme, të tilla si:*

i. Bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratën e rivlerësimit, formularin e aplikimit për legalizim, si dhe vendimin e datës 22.09.1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezultoi e provuar se periudha e ndërtimit të katit përdhes ka qenë 1992 – shtator 1994.

ii. Të dhënat e përfituara sipas këtij dokumentacioni të sipërcituar, parë në këndvështrimin e përcaktimit të periudhës së ndërtimit për këtë kat, i gjen në harmoni me deklaratimet e subjektit në procesverbalin e datës 07.06.2016 të ILDKPKI-së, ku ai ka deklaruar se mobilimi i shtëpisë është modest dhe është kryer që nga viti 1992 e në vijim, me burim të ardhurat familjare, apo edhe në pyetësorin standard, ku subjekti ka specifikuar disa blerje të kryera gjatë periudhës 1992 – 2016, në shumën totale 219.000 lekë.

*iii. Sipas formularit të lejes së ndërtimit, me vendimin nr. {***}, datë 28.06.1994, subjektit i është dhënë leja e ndërtimit për objektin “shtëpi banimi”, ku parashikohet se objekti financohet nga vetë qytetari.*

iv. Nuk disponohen të dhëna zyrtare për periudhën 1992 – 1994, nga EKB-ja, mbi kostot e ndërtimit.

- v. Nuk disponohen të dhëna mbi të ardhurat nga pagat e subjektit përpara periudhës shtator 1994.
- vi. Rezulton se subjekti ka bërë përpjekje për të parashtruar një mënyrë përllogaritjesh, duke paraqitur aktin e ekspertimit, me referencë në materialin “Përmbledhje e manualit të preventivit për vitet 1986 – 1990”.

Këto fakte, në proporcionalitet me rrethanën konstatuese se, në këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrë, si dhe masën e balancës negative në shumën 532.756 lekë, e cila, për arsyet e parashtruara më sipër, nuk duket të jetë reale, çmohen nga Komisioni si të pamjaftueshme për t’i ngritur ato në nivelin e një shkaku penalizues për subjektin, për efekt të këtij procesi. Për sa i përket pretendimit të subjektit për përllogaritjen e shumës së investuar në katin e parë, në masën 650.000 lekë, përkundrejt shumës 2.609.570 lekë të përllogaritur nga Komisioni, ku, si rezultat, është konkluduar në balancë negative në shumën 713.857 lekë, Komisioni ka konstatuar se, edhe pse duket se qëndron pretendimi i subjektit se nuk kemi të bëjmë me një ndërtim nga themelet dhe, për pasojë, edhe kostoja e ndërtimit nuk mund të jetë objektivist real, përsëri, kjo pamjaftueshmëri nuk mbetet plotësisht e provuar, por çmohet në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit për këtë subjekt.

11.1.1. Arsyetimi dhe konkludimi i mësipërm i Komisionit është kundërshtuar nga Komisioneri Publik në ankim, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me pasurinë “banesë dy kate”, ndodhur në lagjen “{***}”, Fier, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik e ka mbështetur në pretendimet, si më poshtë:

(i) Komisioneri Publik ka vlerësuar në ankim se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me pasurinë “banesë dy kate”, si dhe është përpjekur t’i paraqesë ndryshe në deklaratat periodike vjetore shumat e shpenzuara/investuara, lidhur me ndërtimin e katit të parë të këtij objekti, duke parashtruar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit shumën e shpenzuar për investimin e kryer, lidhur me objektin “shtëpi banimi 2-katëshe”, dhe as burimin e krijimit të saj. Gjithashtu, edhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën e investimit për ndërtimin e katit përdhes, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

(ii) Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, lidhur me kohën e ndërtimit të katit të parë (kati i dytë) me sipërfaqe 102 m², vlerëson se ndërtimi i këtij kati është konstatuar i përfunduar, më së paku në shkurt të vitit 2009. Si rezultat, kostoja e ndërtimit të katit të parë të shtëpisë së banimit dykatëshe duhet përfshirë në analizën financiare të vitit 2008. Sipas Komisionerit Publik, nga përfshirja në analizën financiare të vitit 2008 e investimit të kryer për ndërtimin e katit të parë të pasurisë “banesë dy kate”, në vlerën 2.584.761 lekë, sa është përllogaritur nga Komisioni, sipas kostove të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet edhe investimin e kryer për ndërtimin e katit të parë të “banesë dy kate”, në vitin 2008, për një diferencë negative në vlerën 1.844.893 lekë.

(iii) Deklarimet e subjektit në deklaratat periodike për vitet 2008, 2009 dhe 2010, lidhur me shpenzimet/investimet e kryera për ndërtimin e katit të parë me sipërfaqe 102 m², në një vlerë totale rreth 650.000 lekë, janë disa herë më të ulëta se vlera e llogaritur nga Komisioni, bazuar në kostot e

ndërtimit sipas EKB-së, që llogaritet në vlerë totale rreth 2.600.000 lekë, dhe është disa herë më e ulët krahasuar me vlerën e rivlerësuar të këtij objekti në vitin 2011, kur rezulton të jetë rivlerësuar për shumën 17.645.526 lekë.

11.1.2. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura gjatë gjykimit në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, ndërsa në konkluzionet përfundimtare, vlerësoi se, edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, mbeti e provuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me pasurinë “banesë dy kate”, si dhe është përpjekur t’i paraqesë ndryshe në deklaratat periodike vjetore shumat e shpenzuara/investuara, lidhur me ndërtimin e katit të parë të këtij objekti, pasi:

(i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit vlerën e shpenzuar për investimin e kryer për objektin “banesë dy kate”, dhe as burimin e krijimit të saj, si dhe nuk ka deklaruar vlerën e investimit për ndërtimin e katit përdhes në deklaratën e pasurisë së vitit 2003.

(ii) Shpenzimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore për ndërtimin e katit të parë me sipërfaqe 102 m², në shumën rreth 650.000 lekë, janë disa herë më ulëta se vlera e llogaritur nga Komisioni, sipas EKB-së, në shumën rreth 2.600.000 lekë. Gjithashtu, vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit rezulton disa herë më e ulët, krahasuar edhe me vlerën e rivlerësuar të këtij objekti në vitin 2011, në shumën 17.645.526 lekë, rivlerësim i bërë nga institucioni përgjegjës, pak kohë pas ndërtimit të katit të parë.

(iii) Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar një akt vlerësimi tekniko-ekonomik të objektit “banesë dy kate”, ku vlera e punimeve për ndërtimin e katit të parë llogaritet në vlerën 985.344 lekë, vlerë kjo që nuk korrespondon me asnjë nga vlerat e sipërcituara.

(iv) Sa i përket kohës së ndërtimit dhe mbulimit me burime të ligjshme të investimit të kryer për ndërtimin e katit të parë të “banesës dy kate”, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerësoi se, edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, mbeti e provuar se ndërtimi i katit të parë me sipërfaqe 102 m² është konstatuar i përfunduar, më së paku në shkurt të vitit 2009.

11.1.3. Sa më sipër, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme vlerësoi se kostoja e ndërtimit të katit të parë të pasurisë “banesë dy kate” duhet të përfshihet në analizën financiare të vitit 2008 dhe, si rezultat, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet, si dhe investimin e kryer për ndërtimin e katit të parë në vitin 2008, për një diferencë negative në vlerën (-) 1.844.893 lekë, për pasojë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, prapësoi shkaqet e ankimit, në mënyrë të përmbledhur si vijon:

(i) Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, nuk ka specifikuar vlerën totale të shpenzuar për ndërtimin e shtëpisë dhe burimin e saj, si pasojë e një keqkuptimi teknik mbi mënyrën e plotësimit të formularit të deklaratës së rivlerësimit, duke pasqyruar vlerën e rivlerësimit të kësaj pasurie, në kushtet që nuk ka disponuar dokumentacionin provues mbi vlerën e investuar për këtë pasuri. Nuk ka pasur asnjë tendencë për mosdeklaram apo deklaram të pasaktë, për sa kohë që investimet e kryera në

banesë ishin deklaruar në kohë reale, në periudhën që ato ishin kryer, në deklaratat periodike të interesave.

(ii) Lidhur me vlerën e investimit për ndërtimin e katit të parë, pretendimi i Komisionerit Publik është i pabazuar, pasi çmimet e EKB-së nuk janë të detyrueshme për t'u zbatuar në mënyrë uniforme dhe absolute për çdo rast. Komisioneri Publik ka kryer një përlogaritje të investimit, sikur ndërtimi të ishte kryer nga themelet, duke mos marrë parasysh faktin thelbësor që ky investim është kryer mbi një objekt ekzistues. Ndërtimi i katit të parë nuk ka përfshirë punime themelore si: themelet, strukturat mbajtëse, bazamentet apo përgatitjet teknike të terrenit, të cilat, zakonisht, përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të vlerës totale të ndërtimit. Bazuar në "Përmbledhjen e manualit të preventivimit 2", zërat e punimeve ndërtimore për realizimin e themeleve të objektit janë përcaktuar nga eksperti në mënyrë të hollësishme. Këta zëra vërtetojnë se punimet e themeleve dhe strukturave nëntokësore zënë përafërsisht 38-40% të preventivit total të një kati të ndërtuar nga e para. Qasja e Komisionerit Publik, që aplikon mekanikisht çmimet e EKB-së, pa kryer këtë zbritje teknike, arrin në një vlerë të tejfryrë, duke përfshirë në kosto elemente që, në realitetin faktik të ndërtimit, nuk kanë ekzistuar.

(iii) Për periudhën e ndërtimit të katit të parë, pretendimi i Komisionerit Publik bie ndesh me faktet e dokumentuara, pasi shkresa e ASHK-së Fier, nr. {***} prot., datë 07.03.2024, konfirmon qartë se objekti ka qenë i ndërtuar dhe i mbuluar që në mars të vitit 2010, çka do të thotë se, në momentin e kolaudit në shkurt 2009, ndërtimi nuk kishte përfunduar plotësisht. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave konfirmojnë këtë zhvillim progresiv të ndërtimit të katit të parë në vitet 2008, 2009 dhe 2010. Punimet e ndara në vite do të paraqiteshin: 423.698 lekë në vitin 2008, 453.258 lekë në vitin 2009, dhe 108.388 lekë në vitin 2010.

(iv) Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se akti i vlerësimit tekniko-ekonomik, i hartuar nga inxhinierët E. B. dhe F. P., i paraqitur prej tij gjatë gjykimit në Kolegj, i cili ka për objekt vlerësimin teknik dhe financiar të investimit të kryer për ndërtimin e pasurisë "banesë dy kate" në {***}, Fier, ofron një analizë të dyfishtë metodologjike për secilën pjesë të objektit, duke ia nënshtruar verifikimit shkencor të dyja qasjet e mundshme të vlerësimit, dhe duke arritur në përfundime të argumentuara mbi atë që përbën metodën më të përshtatshme dhe më të saktë për përcaktimin e koston reale të investimit të kryer.

(v) Analiza financiare e kryer nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me investimin për ndërtimin e katit të parë, ka evidentuar si mungesë të burimeve të ligjshme për të kryer këtë investim, shumën prej 175.378 lekë, balancë negative që i përket vitit 2009. Për sa i përket analizës financiare të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar rezultatin e arritur nga Komisioni dhe të pranuar nga Komisioneri Publik, duke pretenduar se rezultati negativ prej 134.916 lekësh vjen si pasojë e mosmarrjes në konsideratë të kronologjisë reale të disponimit të likuiditeteve *cash* dhe mënyrës faktike të përdorimit të tyre. Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse balancës negative të vitit 2009 i shtohen edhe balancat negative të rezultuara nga analiza financiare për vitin 2006, në shumën prej 51.771 lekësh dhe, për vitin 2016, në shumën prej 134.916 lekësh, totali i pamjaftueshmërisë financiare për periudhën 1992 – 2016 do të rezultonte në shumën prej (-) 362.064 lekësh, e cila është minimale, dhe nuk ka peshë të tillë që të cenojë besueshmërinë financiare të tij e, për pasojë, në respekt të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo diferencë nuk përbën shkak për vendosjen e një mase disiplinore.

12. Referuar “Aktit të vlerësimit tekniko-ekonomik”, datë 12.01.2026, i hartuar nga inxhinierët E. B. dhe F. P., në cilësinë e ekspertëve të zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, dhe i paraqitur prej tij me parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, si dhe i administruar në cilësinë e provës, për sa i përket investimit për ndërtimin e katit të parë të banesës dy kate, rezultoi se ekspertët kanë krahasuar dy metoda të përllogaritjes së vlerës së ndërtimit.

Sipas metodës së parë, përllogaritja është mbështetur në përcaktimet e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1, datë 20.08.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave për vitin 2008”. Sipas kësaj metode përllogaritjeje, vlera e ndërtimit të katit të parë me sipërfaqe 102 m², me koston mesatare të ndërtimit për qytetin e Fierit prej 27.710 lekë/m², rezulton në vlerën 2.826.420 lekë. Sipas ekspertëve, kjo metodë është e papërshtatshme për rastin konkret, pasi mbart disa mangësi konceptuale si: (i) objekti ka një sipërfaqe të konsiderueshme verande, rreth 30% të sipërfaqes totale të katit të parë; (ii) në llogaritjen e kostos mesatare përfshihen punimet nëntokësore – themele, gërmim dhe mbushje – që, në rastin e katit të parë, nuk janë të aplikueshme; (iii) një pjesë e konsiderueshme e sipërfaqes së katit të parë prej 18,7 m² përfaqëson një ambient të papërfunduar, ku janë kryer vetëm punimet e çatisë dhe muraturës perimetrike.

Sipas metodës së dytë, përllogaritja është mbështetur në hartimin e një preventivi të detajuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1359, datë 10.10.2008 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Ky preventiv ka pasqyruar në mënyrë analitike çdo kategori punimesh, në vlerë totale prej 985.344 lekësh. Ekspertët kanë vlerësuar se kjo metodë jep një situatë më reale të vlerës së investimit, duke marrë parasysh specifikat e objektit dhe mënyrën konkrete të ndërtimit.

13. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “*Truall dhe shtëpi banimi 2-katëshe. Kati i parë 104 m², kati i dytë (papafingo) 102 m² + ambient ndihmës 1 kat 23 m². Truall i marrë nga Komiteti Ekzekutiv Pluralist, datë 19.09.1991. Kati i parë ndërtuar në 1992. Kati i dytë në vitet 2008, 2009, 2010. Vlera 17.645.526 lekë. Rivlerësuar me referencë {***}, datë 29.08.2011. Pjesa takuese: 100%*”.

13.1. Në deklaratimet periodike të interesave ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

Në vitin 2003: “*Shtëpi private 2 dhoma dhe një kuzhinë, {***}, Fier, nr. pasurie {***}. Truall i marrë nga shteti në 1991-shin si i pastrehë. Ndërtuar me të ardhurat e mia*”.

Në vitin 2008: “*Investim në godinën ekzistuese. Vlera 285.000 lekë*”.

Në vitin 2009: “*Depo (objekt ndihmës) e ndërtuar në vitin 1998, e cila është në proces legalizimi, së bashku me truallin e banesës ekzistuese. Vlera 25.000 lekë*”, si dhe “*Investim në banesë, e cila ka të bëjë me shtesë të ambienteve të banimit me sip. 57.6 m². Kati i dytë (proces legalizimi). Vlera 300.000 lekë*”.

Në vitin 2010: “*Truall + banesë 2kt + ambient ndihmës, përfutur nga procesi i legalizimit. Vërtetimi hipotekor nr. {***}, datë 18.06.2010. Sipërfaqe trualli 300 m². Sipërfaqe banese 104 m², kati i parë, 102 m², kati i dytë, ambienti ndihmës 23 m². Vlera 429.493 lekë. Një pjesë e kësaj vlere është paguar me bono privatizimi (70%) dhe pjesa tjetër me lekë në dorë, sipas konfirmave bankare nr. {***}, datë 28.04.2010, pranë Credins Bank, me vlerë 280.000 lekë. Me nr. {***}, datë 28.04.2010, Credins Bank, me vlerë 120.000 lekë. Konferma bankare nr. {***}, datë 03.03.2010, me vlerë 25.493 lekë.*”

[...] Investime në banesë, të cilat kanë të bëjnë me ambientet e brendshme të shtëpisë. Vlera 74.000 lekë”.

Në vitin 2016: “Shtëpi banimi e deklaruar në vite, nuk janë bërë ndryshime. Lëshuar certifikatë e pasurisë nr. {***}, datë 31.01.2017”.

13.2. Në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Për sa i përket aspektit deklarativ të deklarimit të burimit dhe shumës së shpenzuar për ndërtimin, dua të evidentoj, së pari, faktin se kjo vjen si pasojë e keqkuptimit tim në mënyrën e përpilimit të deklaratës vetting, ku duke deklaruar origjinën e përfitimit të këtij trualli, i cili vjen si rrjedhojë e vendimit të dhënë nga Komiteti Ekzekutiv Pluralist, më datë 19.09.1991, vlerën e kësaj pasurie pas rivlerësimit të kryer më datë 29.08.2011, si dhe kohën e ndërtimit të saj, në këtë mënyrë, kam menduar se kam ezauruar detyrimin tim ligjor lidhur me mënyrën e deklarimit të kësaj pasurie në deklaratën e rivlerësimit. Ndërkohë që, vlerën e investimit të kryer nga ana ime, e kam deklaruar rregullisht në çdo deklaram periodik vjetor përkatës”.

13.3. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, lidhur me deklaramet e subjektit në deklaratën e rivlerësimit dhe në deklaramet periodike vjetore të interesave, trupi gjykues vëren se subjekti, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, nuk ka deklaruar vlerën e investimit për ndërtimin e banesës 2-katëshe në pronësi të tij dhe personit të lidhur, dhe as burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke mos iu përgjigjur kërkesave të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, dhe kërkesave të vetë formularit të deklarimit. Edhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën e investuar në ndërtimin e katit përdhes të kësaj pasurie. Në deklaramat periodike të viteve në vijim, nga subjekti i rivlerësimit janë deklaruar, përkatësisht në vitin 2008, vlera e investimit në godinën ekzistuese, në vitin 2009, vlera e investuar në ndërtimin e katit të parë, dhe, në vitin 2010, vlera e paguar për legalizimin e banesës së ndërtuar. Vlera e pretenduar e investimit për ndërtimin e banesës dhe burimet e krijimit të saj janë shpjeguar prej subjektit të rivlerësimit vetëm në përgjigjet e dhëna pas kërkesave të drejtuara nga Komisioni nëpërmjet pyetësorëve. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me vlerën e investimit për ndërtimin e banesës 2-katëshe dhe burimin e krijimit të saj, duke u gjendur në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për pasojë, pretendimi i Komisionerit Publik, i konfirmuar edhe nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjendet i drejtë.

13.4. Sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik në ankim, se subjekti i rivlerësimit është përpjekur t’i paraqesë ndryshe në deklaramat periodike vjetore shumëat e shpenzuara/investuara lidhur me ndërtimin e katit të parë të këtij objekti, pasi deklaramet e subjektit në deklaramat periodike për vitet 2008, 2009 dhe 2010, lidhur me shpenzimet/investimet e kryera për ndërtimin e katit të parë, janë disa herë më të ulëta se vlera e llogaritur nga Komisioni, bazuar në kostot e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, dhe është disa herë më e ulët krahasuar me vlerën e rivlerësuar të këtij objekti në vitin 2011, trupi gjykues vlerësoi se, për këto deklaramet, ashtu siç analizohet në vijim të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë vlerën e investimeve të deklaruara dhe, për këtë problematikë, ai ka marrë pasojën e llogaritjes së investimeve në analizën financiare, jo sipas vlerave të deklaruara prej tij, por sipas kostove të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave, për pasojë, kjo situatë nuk duhet të barazohet me një deklaram të pasaktë, duke e ndëshkuar subjektin e rivlerësimit

dy herë për të njëjtën shkelje. Gjithashtu, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i Komisionerit Publik për deklarime të pasakta në deklaratat e interesave të viteve 2008, 2009 dhe 2010, referuar jurisprudencës së Kolegjit, nuk përfshihen brenda përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, por ato mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

13.5. Komisioneri Publik, në ankim, dhe përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, lidhur me kohën e ndërtimit të katit të parë me sipërfaqe 102 m², kanë vlerësuar se ndërtimi i këtij kati është konstatuar i përfunduar, më së paku në shkurt të vitit 2009. Si rezultat, kostoja e ndërtimit të katit të parë të banesës dykatëshe duhet përfshirë në analizën financiare të vitit 2008. Sipas Komisionerit Publik, konfirmuar edhe nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nga përfshirja në analizën financiare të vitit 2008 të investimit të kryer për ndërtimin e katit të parë në vlerën 2.584.761 lekë, sipas kostove të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimin e kryer për ndërtimin e këtij kati në vitin 2008, për një diferencë negative prej (-) 1.844.893 lekësh.

13.5.1. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, për pasurinë “banesë dykatëshe”, ndodhur në lagjen “{***}”, Fier, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi situatën faktike, si më poshtë:

Referuar dokumentacionit justifikues që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, si dhe informacionit të përcjellë në Komision nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresë nr. {***} prot., datë 12.02.2021, rezultoi se:

- Me vendimin nr. {***}, datë 19.09.1991, Komiteti Ekzekutiv Pluralist i Sheqit të Vogël ka vendosur t’i japë z. Petrit Vukaj truall për ndërtim shtëpie. Sipas formularit të lejes së ndërtimit, me vendimin nr. {***}, datë 28.06.1994, subjektit të rivlerësimit i është dhënë leja e ndërtimit për objektin “shtëpi banimi”, ku parashikohet se objekti financohet nga vetë qytetari/subjekti. Me vendimin nr. {***}, datë 22.09.1994, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për vërtetim fakti, duke e njohur bashkëpronar me bashkëshorten e tij mbi objektin “shtëpi banimi njëkatëshe e ndodhur në {***}, e përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, aneks, korridor, banjë e verandë”.

- Në formularin e ALUIZNI-t, “Vetëdeklarimi për legalizim objekti”, me nr. {***} prot., datë 05.10.2006, vetëdeklaruesi, z. Petrit Vukaj, ka deklaruar: Shtëpi banimi 1 kat, me adresë: lagja “{***}”, viti i ndërtimit 1992, sipërfaqe e zënë 300 m², sipërfaqe ndërtimi 102 m² dhe garazh 23,60 m². Bashkëlidhur gjenden fotot e objektit, ku konstatohet se objekti është 1 kat (pa papafingo).

- Në Aktin e Kualifikimit nr. {***}, datë 29.04.2010, të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, pasqyrohet se objekti informal: “Ka 300 m² parcelë ndërtimore, sipërfaqe të bazës së objektit 127 m², nr. katesh 1 (një)”.

- Në aktin e kontrollit, të ushtruar nga Drejtoria e Urbanistikës, Këshilli i Qarkut Fier, më datë 02.02.2009, pasqyrohet se: “[...] Gjatë kontrollit të ushtruar, u vërejt se objekti ka përfunduar, funksionon banesë, zbatuar sheshi i ndërtimit”.

- Sipas lejes së shfrytëzimit të objektit, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanistikës, Këshilli i Qarkut Fier, më datë 20.02.2009: “[...] Nga verifikimi në vend, u konstatua se objekti ka filluar funksionimin sipas destinacionit të miratuar, në sheshin dhe lejen e ndërtimit nga KRRt-ja përkatëse”.

- Sipas akt-kolaudimit, datë 03.02.2009, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e investitorit, si dhe nga mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori, nga verifikimet në vend, nga kolaudatori është konstatuar se sipërfaqja e sheshit është 256 m²; sipërfaqja e ndërtimit të katit përdhes është 102 m²; sipërfaqja e ndërtimit të katit të parë është 102 m². Gjithashtu, sipas përmbajtjes së aktit të kolaudimit, *nga kontrolli i ushtruar në objekt, rezulton se kanë përfunduar të dyja katet dhe janë gati për shfrytëzim.*
- Ndërmjet ALUIZNI-t dhe subjektit të rivlerësimit, është lidhur kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.04.2010, me anë të cilës, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar pronësia e parcelës me sipërfaqe 300 m². Bashkëlidhur kontratës, gjendet formulari i datës 28.04.2010, i pagesës së blerjes së parcelës me bono privatizimi, ku vlera totale e parcelës është llogaritur në shumën 400.000 lekë, nga të cilat, 70% e totalit është paguar me bono privatizimi, në shumën 280.000 lekë, si dhe formulari i pagesës në lekë, i datës 28.04.2010, për pjesën e mbetur prej 120.000 lekësh. Subjekti i rivlerësimit ka paguar shumën totale prej 149.493 lekësh pranë Credins Bank.
- Në favor të z. Petrit Vukaj, nga ALUIZNI është dhënë leja e legalizimit me nr. {***}, datë 26.05.2010, për objektin “Godinë banimi 1 kat + objekt ndihmës 1 kat”, me këto të dhëna: “zona kadastrale {***}, nr. pasurisë {***}; sipërfaqja e parcelës ndërtimore 300 m²; sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 104 m², numri i kateve mbi tokë 1 (një), objekt ndihmës me sipërfaqe 23 m²”.
- Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor, datë 18.06.2010, në pronësi të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria nr. {***}, ZK {***}, me sipërfaqe 300 m² në adresën “{***}”, Fier, me përshkrimin: “*Truall dhe banesë 2 kate. Kati i parë 104 m², kati i dytë 102 m² + ambient ndihmës 1 kat, 23 m²*”.
- Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, të datës 31.01.2017, në pronësi të subjektit të rivlerësimit është regjistruar pasuria nr. {***}, ZK {***}, me sipërfaqe 300 m² truall dhe 104 m² ndërtesë, ku, në seksionin “Përshkrim i veçantë” shënohet: “*Shtëpi banimi me papafingo, me ref. {***} [...] sipas lejes së legalizimit nr. {***}, datë 26.05.2010, banesa 104 m², ambienti ndihmës 23 m²*”. Në vijim, është pasqyruar shënimi: *Me ref. {***}, bëhet rivlerësimi i pasurisë në vlerën 17.645.526 lekë. Kati përdhes 104 m². Kati i parë 102 m². Ambient ndihmës 23 m²*”.
- Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 07.03.2024, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, ka informuar subjektin e rivlerësimit¹² si vijon: “[...] nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, rezulton se qytetari ka qenë i pajisur me leje ndërtimi, miratuar me vendimin nr. {***}, datë 28.06.1994, të KRRt-së së Këshillit të Rrethit Fier. Ky objekt është pajisur me akt kolaudimi më datë 03.02.2009, emërtimi i objektit ‘banesë dy kate’, në lagjen ‘{***}’, Fier, ku përcaktohet se, në kontrollin e ushtruar në objekte, rezulton se kanë përfunduar të dyja katet dhe janë gati për shfrytëzim. Punimet përputheshin me dokumentacionin teknik të miratuar në KRRt dhe të arkivuara pranë Urbanistikës së Qarkut. Gjithashtu, objekti është i pajisur me leje shfrytëzimi nga Këshilli i Qarkut Fier, Drejtoria e Urbanistikës, datë 20.02.2009, bashkëlidhur aktkontrolli, ku përcaktohet se objekti ka përfunduar, funksionin si banesë dhe është zbatuar sheshi i ndërtimit. I gjithë ky dokumentacion është përcjellë për regjistrim pranë ish-ZVRPP-së Fier, nga Këshilli i Qarkut Fier,

¹² Dokument i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur përgjigjeve mbi pyetëtorin nr. 1, të drejtuar nga Komisioni.

me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 23.02.2009. [...] Sektori i legalizimit dhe hartografisë në AShK Fier, pas kërkesës tuaj, bazuar në VKM-në nr. 1178, datë 24.12.2020, Kreu III, pika 16, shkronja “b” (imazhet satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjekti disponues) ka verifikuar faktin dhe afatin e ndërtimit të këtij objekti dhe, nga ky verifikim, rezulton se në muajin mars 2010, objekti ka qenë i përfunduar në strukturë, volume dhe mbulesë, pa pësuar ndryshime gjatë viteve në vazhdim, gusht 2013, gusht 2014, qershor 2015, korrik 2023, fotografimi i fundit në programin Google Earth Pro”.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 1 të drejtuar nga Komisioni, në lidhje me kohën e ndërtimit të katit të parë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Konkretisht, katin e parë të ndërtesës (papafingo) kam filluar që ta ndërtoj në vitin 2008 dhe ka përfunduar pothuajse në 2009 dhe, totalisht, në vitin 2010. Në total, kati i parë ka kushtuar 650.000 lekë, vlerë të cilën e kam investuar pjesë-pjesë. Në deklaratën e vitit 2008, që përkon me investimin e bërë në katin e dytë të banesës, investim i bërë në vitin 2008, shtesa në katin e parë ka qenë 57.6 m². Më pas, në vitin 2009, kanë vazhduar punimet, duke përfunduar e gjitha shtesa, sipas lejes së ndërtimit, në total 102 m². Për ndërtimin e kësaj shtese, e cila është me konstrukcion metalik, ka kontribuar kunati im (vëllai i gruas), i cili, në profesion, është saldator me kategori të shtatë. Ai e ka ndërtuar totalisht nga ana konstruktive katin e parë të banesës”.

- Në rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka përsëritur qëndrimin e tij të shprehur në përgjigjen e pyetësorit nr. 1, si më sipër, dhe ka përsëritur gjithashtu se vlera e investimit për ndërtimin e këtij kati është, në total, në shumën 650.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka kontestuar përlllogaritjen e vlerës së ndërtimit nga Komisioni, bazuar në çmimet e EKB-së, duke pretenduar se punimet e ndërtimit për këtë kat janë kryer mbi një ndërtesë ekzistuese, pra, nuk ka pasur nevojë të bëhen themele nga e para dhe, punime fillestare, të cilat, sipas tij, përbëjnë 44.1% të punës, sipas zërave të preventivit. Në këtë logjikë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, edhe në rastin e referencës në çmimet sipas EKB-së, nga ana e Komisionit duhej të ishte përlllogaritur një vlerë shpenzimesh, të paktën 44.1% më pak nga çka është përlllogaritur.

13.6. Në analizë të të gjitha të dhënave të pasqyruara më sipër, trupi gjykues vlerësoi se, lidhur me kohën e përfundimit të ndërtimit të katit të parë, dalin në pah disa fakte e rrethana, të cilat janë me vlerë për zgjidhjen e pretendimit të Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, të cilat renditen si më poshtë:

a) Në deklaratat periodike të interesave, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar investim në banesën ekzistuese në vitin 2008 dhe investim për shtesë të ambienteve të banimit, përkatësisht në vitin 2008 dhe 2009, ndërsa, në vitin 2010, ka deklaruar kostot e legalizimit të ndërtimit të realizuar dhe investime që kanë të bëjnë me ambientet e brendshme të banesës, dhe jo me ndërtim rishtas të kryer në të.

b) Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 dhe në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, vetë subjekti i rivlerësimit ka pohuar se, në vitin 2009, kanë vazhduar punimet, duke përfunduar e gjitha shtesa, sipas lejes së ndërtimit, në total 102 m².

c) Nga dokumentacioni i hartuar pas kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Urbanistikës së Këshillit të Qarkut Fier, për shkak të regjistrimit të banesës në regjistrin e pasurive të paluajtshme në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, referuar ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” (i ndryshuar), ka rezultuar se, më datë 02.02.2009, objekti

ishte i përfunduar dhe funksiononte si banesë, e, më tej, është lëshuar edhe leja e shfrytëzimit të objektit dhe, sipas aktit të kolaudit, datë 03.02.2009, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e investitorit, si dhe nga mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori, nga verifikimet në vend, nga kolaudatori është konstatuar se sipërfaqja e sheshit është 256 m², sipërfaqja e ndërtimit të katit përdhes është 102 m², sipërfaqja e ndërtimit të katit të parë është 102 m². Gjithashtu, sipas përmbajtjes së aktit të kolaudit, nga kontrolli i ushtruar në objekt, rezulton se kanë përfunduar të dyja katet dhe janë gati për shfrytëzim. I njëjti interpretim i fakteve është bërë edhe nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, e cila ka informuar Komisionin dhe subjektin e rivlerësimit se përmbajtja e akteve të sipërcituara i përgjigjet objektivisht së vërtetës, pasi ka verifikuar faktin dhe afatin e ndërtimit të këtij objekti dhe, nga ky verifikim, rezulton se, në muajin mars 2010, objekti ka qenë i përfunduar në strukturë, volume dhe mbulesë, pa pësuar ndryshime gjatë viteve në vazhdim, gusht 2013, gusht 2014, qershor 2015, korrik 2023, sipas fotografimit të fundit në programin *Google Earth Pro*.

13.6.1. Në mbështetje të këtyre rrethanave dhe fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ dhe të pakontestuara nga fakte apo prova të tjera të besueshme gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit se, sa i përket katit të parë të banesës, *subjekti, në vitin 2009, ka ndërtuar sipërfaqen prej 57,6 m² dhe, në vitin 2010, sipërfaqen prej 44,4 m²*, nuk është i bazuar në fakte dhe prova. Nga tërësia e rrethanave dhe fakteve të analizuara si më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se, gjendet i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se ndërtimi i katit të parë, me sipërfaqe 102 m², është konstatuar i përfunduar në fund të vitit 2008 dhe, për pasojë, kostoja e ndërtimit të këtij kati, duhet përfshirë në analizën financiare të vitit 2008, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të përballuar me burime të ligjshme ndërtimin e tij.

13.7. Sa i përket koston e ndërtimit të katit të parë, trupi gjykues vëren se, referuar arsyetimit lidhur me periudhën e ndërtimit, Komisioni, në vendim, ka kryer përlllogaritjet për shumën e kostove të ndërtimit për vitet 2008, 2009 dhe 2010, duke zbritur, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,55%, nga ku i rezultoi një kosto totale prej 2.609.570 lekësh. Nga Komisioneri Publik, në ankim, dhe përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj, kostoja e ndërtimit të katit të parë, duke vlerësuar se ndërtimi ka përfunduar, më së paku në shkurt të vitit 2009, është përlllogaritur në vlerën 2.826.420 lekë (102 m² x 27.710 lekë/m²) dhe, duke zbritur nga kjo shumë vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,55%, kostoja e ndërtimit të këtij kati është llogaritur në vlerën 2.584.761 lekë.

13.8. Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar se akti i vlerësimit tekniko-ekonomik, datë 12.01.2026, i hartuar nga ekspertët e zgjedhur prej tij dhe i paraqitur me parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, si dhe i administruar në cilësinë e provës, jep një situatë reale të vlerës së investimit, në vlerë totale prej 985.344 lekësh, duke marrë parasysh specifikat e objektit dhe mënyrën konkrete të ndërtimit, sipas një preventivi të hartuar në mënyrë analitike për çdo kategori punimesh, mbështetur në përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1359, datë 10.10.2008, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

13.9. Trupi gjykues vlerësoi se ky preventiv, i përgatitur rreth 18 vjet më vonë nga koha e kryerjes së ndërtimit të katit të parë nga ekspertët e përzgjedhur nga vetë subjekti, dhe i paraqitur gjatë procesit

të rivlerësimit, është një akt jobindës dhe joreferues për përcaktimin e kostos mesatare dhe llogaritjen e vlerës së ndërtimit të këtij kati. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues që do të provonte çmimet dhe shpenzimet e kryera nga subjekti për ndërtimin e katit të parë në kohën e kryerjes së tyre, trupi gjykues vlerësoi se referimi nga ana e Komisionit, Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në çmimet e përcaktuara në vlerat e kostove të ndërtimit, publikuar nga EKB-ja, si dhe në kriteret për ndërtimin e banesave, si e vetmja referencë ligjore për përcaktimin e çmimeve, është një qëndrim i drejtë, i konsoliduar tashmë, edhe nga jurisprudenca e Kolegjit. Referimi në këto kosto ndërtimi, të përcaktuara me vendimet dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave, është jo vetëm kriter ligjor i drejtë, por do t'i vendoste të gjitha subjektet e rivlerësimit në një trajtim të barabartë në mënyrën e përlllogaritjeve të vlerave të pasurive të tyre, në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues për vlerën e ndërtimeve të tyre.

13.9.1. Trupi gjykues, për të garantuar një gjykim sa më të drejtë, duke marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, vlerën e investimit e përlllogarit në shumën 1.581.370 lekë. Kjo shumë rezultoi duke korrigjuar vlerën e kostos së objektit, sipas çmimit për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit, në shumën 2.826.420 lekë ($102 \text{ m}^2 \times 27.710 \text{ lekë/m}^2$), referuar vlerave të përcaktuara, sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 20.08.2008, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banësive, për vitin 2008", bazuar në qëndrimet si vijojnë:

(a) Në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit¹³, nuk u përfshinë në vlerën e investimit, vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar, në masën 8,55%.

(b) Në kushtet kur rezultoi e provuar se ndërtimi i katit të parë të banesës është kryer mbi katin përdhes ekzistues, trupi gjykues e vlerësoi të logjikshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, zërat e punimeve ndërtimore për realizimin e themeleve për ndërtimin e katit të parë nuk janë kryer dhe, për pasojë, vlera e tyre duhet të zbritet. Në përlllogaritjen e kësaj vlere, trupi gjykues u mbështet në preventivin e punimeve të katit përdhes, i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, sipas të cilit, vlera e zërave të punimeve, të referuara për ndërtimin e themeleve, përbënte 8% të vlerës së plotë të ndërtimit. Për rrjedhojë, çmimi për metër katror për ndërtimin e katit të parë u përlllogarit duke e reduktuar këtë çmim në masën 8%.

(c) nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe të administruara në cilësinë e provës gjatë shqyrtimit gjyqësor, konkretisht, nga fotot e banesës të paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nga të dhënat e prezantuara në aktin e vlerësimit të ekspertëve të zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, dhe nga fotot që shoqëronin këtë akt, rezultoi e provuar se sipërfaqja prej 102 m^2 e katit të parë përbëhet nga $18,7 \text{ m}^2$ sipërfaqe e pashfrytëzuar në fazën karabina dhe $30,6 \text{ m}^2$ verandë. Këtyre ndërtimeve, në tërësi, i mungojnë disa elemente strukturore në raport me një objekt të përfunduar të tipit banesë¹⁴, për të cilat, EKB-ja, në bazë të udhëzimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, përcakton çmimet referuese. Në këto kushte, trupi gjykues konsideroi investimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit për sipërfaqen e pashfrytëzuar të mbetur në fazën karabina, në raportin 40% të çmimit për m^2 dhe, për sipërfaqen verandë, në raportin 25% të çmimit për m^2 , në referencë edhe të qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji në disa vendime të dhëna prej tij¹⁵.

¹³ Vendimi i Kolegjit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019 dhe nr. 06/2022 (JR), datë 17.03.2022 etj.

¹⁴ Bazuar në manualin e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, miratuar me udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

¹⁵ Vendimi i Kolegjit nr. 21/2020 (JR), datë 10.09.2020 dhe vendimi i Kolegjit nr. 6/2023 (JR), datë 22.02.2023.

13.9.2. Trupi gjykues, vlerën e investimit të përlllogaritur sipas metodologjisë së sipërcituar, ia nënshtrroi analizës financiare, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e investimit dhe të shpenzimeve të tjera në vitin 2008, në shumën (-) 841.502 lekë.

13.10. Komisioneri Publik, në ankim dhe përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj, kanë çmuar të theksojnë se, edhe nëse merren në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ndërtimi është kryer në vitet 2008, 2009, 2010, përveç sa është konstatuar lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare, në këtë variant, në kushtet kur ndërtimi i kryer pa leje u parashikua si vepër penale me ndryshimet ligjore të Kodit Penal të miratuara në vitin 2008, eventualisht, do të përbënte shkelje të etikës së magjistratit, pasi një sjellje e tillë e jashtme, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti dhe autoriteti i sistemit të drejtësisë, është objekt rregullimi i normave të etikës së prokurorit dhe pjesë e standardeve që udhëzojnë shembuj më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Në këtë kuptim, edhe në këtë eventualitet, ky konstatim do të duhej të merrej në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit i prapësoi këto pretendime gjatë gjykimit në Kolegj, duke parashtruar se, lidhur me shkeljen etike dhe ligjore të pretenduar nga Komisioneri Publik, ky pretendim nuk merr parasysh zhvillimet legjislativë përkatëse. Sipas subjektit të rivlerësimit, ligji nr. 9482/2006, në formën e tij fillestare, parashikonte se përfitimi nga procedurat e legalizimit mund të bëhej vetëm për ndërtimet e kryera përpara datës 03.04.2006, por kjo dispozitë është ndryshuar me ligjin nr. 141/2013, i cili ka krijuar një përjashtim të qartë, duke lejuar legalizimin, edhe për ndërtimet e ngritura pas vitit 2006, për sa kohë ato nuk përfshinin kalim pronësie mbi truallin. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, për më tepër, posedonte leje ndërtimi të rregullt të vitit 1994 për një banesë dy kate, çka do të thotë se ndërtimi i katit të parë është kryer në përputhje me lejen ekzistuese.

13.10.1. Në mbështetje të konkluzionit të arritur më sipër në këtë vendim, se punimet e ndërtimit për katin e parë kanë përfunduar në fund të vitit 2008, si dhe në referencë të faktit se dispozitat ligjore që parashikonin ndërtimin pa leje si vepër penale, kanë hyrë në fuqi në janar të vitit 2009, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka shkelur etikën e magjistratit e, për rrjedhojë, nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

14. Në konkluzion, për pasurinë “banesë dy kate”, në {***}, Fier, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e investimit të katit të parë e, për pasojë, gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e të njëjtit ligj.
15. Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit, *për automjetin tip “DaimlerChrysler”, me targa {***}, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke u ndodhur në kushtet e nenit 61, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si vijon.

16. Në përfundim të hetimit administrativ për pasurinë “automjet” tip “DaimlerChrysler”, me targa {***}, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, Komisioni në vendim ka konstatuar situatën faktike si më poshtë.

16.1. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “Automjet tip ‘DaimlerChrysler’, C220CDI, viti i prodhimit 2001, me targa {***}. Blerë në vitin 2009. Vlera 3.600 euro + 348.430 lekë, shumë e përfituar nga shitja e Benzit, me targë {***}. Pjesa në %: 100%”.

16.2. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shitje makine me targa {***}, ndryshuar në {***} (për shkak të dëmtimit të saj). Akt i shitjes nr. {***}, dt. 04.04.2009. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa në %: 100%. Blerje makine tip “Benz”, akt shitblerje nr. {***}, datë 28.04.2009. Vlera: 3.600 euro (460.800 lekë, 1 euro=128 lekë). Pagesa në doganën shqiptare datë 07.05.2009. Vlera: 348.430 lekë. Totali i vlerës së makinës së blerë 809.230 lekë”.

16.3. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, si dhe akteve të dosjes së mjetit, të përcjellë në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor¹⁶, rezultoi se me aktin e shitblerjes, së datës 28.04.2009, subjekti i rivlerësimit ka blerë në Gjermani automjetin tip “DaimlerChrysler”, prodhim i vitit 2001, kundrejt çmimit 3.600 euro. Ky automjet është zhdoganuar në datën 07.05.2009 dhe, sipas mandatit bankar të datës 07.05.2009, subjekti i rivlerësimit ka paguar detyrime doganore në vlerën 348.430 lekë.

16.4. Komisioni ka analizuar blerjen dhe shitjen e automjetit me targa {***}, pasi sipas deklaramit të subjektit në deklaratën e rivlerësimit, si dhe në deklarimet e tij në përgjigje të pyetësorit standard të drejtuar nga Komisioni,¹⁷ të ardhurat nga shitja e këtij automjeti kanë shërbyer si burim për financimin e blerjes së automjetit tip “DaimlerChrysler”, me targa {***}, në vitin 2009.

16.4.1. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Automjet tip ‘Benz’, me targa {***}. Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol. Vlera 250.000 lekë”.

Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin financiar të krijimit të kësaj pasurie, por në përgjigje të pyetësorit standard, të drejtuar nga Komisioni, ka deklaruar se: “Me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.08.2005, kam blerë automjetin me targa {***}, ndryshuar targën në {***}. Në këtë rast, mënyra e pagesës ka qenë cash në dorë dhe është pasqyruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2005. Shpenzimet janë mbuluar nga paga ime dhe e bashkëshortes”.

16.4.2. Sipas dokumentacionit të përcjellë në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor rezultoi se, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.08.2005, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga z. S. S. automjetin me targa {***}, tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1992, me çmim 250.000 lekë, të cilit më pas i ka ndryshuar targën në {***}. Z. S. S. e ka blerë automjetin në fjalë në Gjermani, me anë të kontratës së shitblerjes së datës 30.11.2004, në vlerën 250 euro.

¹⁶ Sipas dokumentacionit të përcjellë në Komision, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 16.10.2023.

¹⁷ Në përgjigje të pyetësorit standard të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar se: “Më datë 28.04.2009, kam blerë automjetin me targë {***}, në Gjermani, përkundrejt vlerës 3.600 euro. Kjo është përballuar nga shitja e mjetit të parë, me targë {***}, në vlerën 1.000.000 lekë. Në të gjitha rastet, mënyra e pagesës ka qenë cash në dorë.”

16.4.3. Komisioni në vendim ka pasqyruar analizën financiare të kryer për verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në shumën prej 250.000 lekësh, në datën 15.08.2005, nga e cila ka rezultuar se ata kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

Sa i përket shitjes së këtij automjeti, nga subjekti i rivlerësimit të blerësi, z. A. Z., Komisioni ka konstatuar se, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.04.2009, çmimi i shitblerjes ishte 1.000.000 lekë¹⁸.

16.4.4. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 07.06.2016, lidhur me konstatimin se automjeti, i blerë në vlerën 250.000 lekë, pas 4 viteve përdorimi, është shitur në një vlerë 4-fish më të lartë se çmimi i blerjes, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se arsyeja e shitjes së mjetit me një vlerë të tillë ka qenë mirëmbajtja e tij dhe rritja e vlerës për shkak të zhdoganimit.

16.4.5. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si vijon:

(i) *Subjekti ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me shpenzimet apo investimet e kryera për rritjen e vlerës së automjetit me targa {***}. Për pasojë, çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 04.04.2009, në shumën 1.000.000 lekë, nuk është marrë në konsideratë në analizën e burimit të ligjshëm për blerjen e automjetit tjetër, me targë {***}.*

(ii) *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 559.230 lekë, për blerjen e automjetit me targë {***}, në vitin 2009.*

16.4.6. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

“Kjo pasuri është blerë nga ana ime me një çmim okazion, për shkak se pala shitëse donte ta shiste automjetin në një kohë të shpejtë dhe nuk donte të investonte mbi këtë send të luajtshëm, por duke përfshirë këtu edhe indikatorë të tjerë, sikundër gjendja e mjetit në momentin e ardhjes në Shqipëri. Vlera fillestare e blerjes së këtij automjeti, sikundër edhe Komisioni thekson, është marrë prej shitësit S. S., në çmimin prej 250 euro, në shtetin gjerman, pa përfshirë këtu shpenzimet doganore të kryera nga pala shitëse. Çmimi i vendosur për këtë automjet, në vlerën prej 250.000 lekë, lidhet me faktin se mjeti nuk ishte në gjendjen e tij më të mirë, kishte problemet e tij motorike, cilësia e kondicionerit ishte e dobët dhe kishte nevojë për riparime të tjera, në mënyrë që t’i jepja funksionet e duhura të përdorimit, investime që kërkonin kosto edhe më të larta se ajo e blerjes. Për shkak se mjeti kishte nevojë të ishte në gjendjen më të mirë funksionale e dërgova pranë një servisi në qytetin e Fierit, te shtetasi I. C., i cili, që prej vitit 2002, ka patur dhe vijon të ketë një aktivitet tregtar të serviseve të automjeteve, tregtim të pjesëve të këmbimit etj. [...]. Për arsyet që shpjegova më lart, kam blerë një motor të ri dhe ia kam instaluar automjetit, por vlerat e tyre e kam të vështirë t’i përcaktoj, për shkak të kohës së largët të shkuar. Rreth një viti më pas, pra në vitin 2008, kam vendosur dhe impiantin e kondicionerit, si dhe kam kryer rregullime të klimatizatorit [...]. Lidhur me paraqitjen e dokumentacionit për investimet e kryera, në kushtet kur unë nuk kam patur detyrim ligjor të deklaroj investimet e kryera, nuk kam mbajtur dokumentacion, pasi kam menduar se nuk do të më nevojitet ndonjëherë, por mbaja mend shumë mirë se kush ka qenë personi që ka kryer këto përmirësime/rregullime të automjetit dhe, për këtë arsye, shtetasi I. C. dhe shtetasi S. S. kanë lëshuar deklarata noteriale, me qëllim vërtetimin e deklarimeve të mia. [...]”.

¹⁸ Më tej, z. A. Z., në datën 01.12.2015, e ka shitur automjetin për vlerën 100.000 lekë.

16.4.7. Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur:

(i) Deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.02.2024, në të cilën deklaruesi S. S. shpjegon se: “[...] Në muajin gusht të vitit 2005 [...] unë kam kryer kontratë shitblerje mjeti, autoveturë me këto të dhëna: marka – “Benz”, tipi - 200 D, ngjyra - blu, targa – {***}, karburanti - naftë, lloji - autoveturë. Këtë autoveturë unë ia kam shitur shtetasit Petrit Vukaj, për vlerën prej 250.000 lekësh. Deklaroj se këtë mjet unë e kam shitur me sandokart të çarë dhe me motorin e djegur, kurse nga pjesët e tjera teknike dhe xhenerike mjeti ka qenë në gjendje të rregullt”.

(ii) Deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.05.2024, në të cilën deklaruesi I. C. ka shpjeguar se: “[...] Rreth vitit 2005, i kam shitur shtetasit Petrit Vukaj një motor makine të përdorur për mjet “Mercedes-Benz (200)”, me lënde djegëse diesel. Po kështu, këtë motor, mjetit “Benz 200 D”, ngjyrë blu e errët, të këtij shtetasi, ia kam montuar në servis tim. Për motorin e dëmtuar që kishte mjeti, duke qenë se unë tregtoj pjesë të përdorura, ia kam blerë unë, duke i bërë zbritje nga vlera e motorit që i kam shitur. [...] Pas rreth një viti, ky shtetas ka sjellë përsëri makinën në servis tim për të riparuar impiantin e kondicionerit, sepse e kishte jashtë funksionit. [...] Shërbimet periodike të këtij mjeti “Benz 200 D”, ky shtetas i ka kryer pranë servisit tim, ku i kam bërë përmirësime përgjatë viteve, duke i rritur kualitetin e mjetit. [...] Vlerat e paguara nuk më kujtohen, sepse ka kaluar një kohë e gjatë”.

17. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, në vendim,¹⁹ Komisioni ka arsyetuar se vlera e shitjes së këtij automjeti është jashtë logjikës financiare, sipas së cilës një mjet që përdoret, amortizohet dhe, për pasojë, nuk mund të shitet më shtrenjtë. Deklaratat noteriale të shtetasve S. S. dhe I. C. janë marrë me rezervë nga trupi gjykues, pasi janë paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit dhe nuk kanë efekt provues në këtë proces, si dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit. Në kushtet që subjekti i rivlerësimit, në funksion të barrës së provës, nuk arriti të provojë shpenzimet e kryera të pretenduara si investime të kryera për rritjen e vlerës së automjetit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, për efekt të analizës financiare, Komisioni vlerësoi të konsiderojë vetëm shumën 250.000 lekë, si vlerë e ligjshme e përfutur nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, që përkon me çmimin e blerjes së këtij mjeti në vitin 2005, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 559.230 lekë, për blerjen e automjetit me targë {***}, në vitin 2009, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

17.1. Komisioneri Publik në ankim, lidhur me pasurinë “automjet”, tip “DaimlerChrysler”, me targë {***}, ka çmuar të drejtë arsyetimin dhe vlerësimin e Komisionit për të mos përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme, për blerjen e tij, shumën 1.000.000 lekë nga shitja e automjetit të mëparshëm tip “Mercedes-Benz”, si dhe konstatimin lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në vlerën (-) 559.230 lekë.

Sipas Komisionerit Publik, çmimi i shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në vlerën 1.000.000 lekë, nga subjekti i rivlerësimit, duket të jetë në kushtet e një veprimi juridik fiktiv/i simuluar, që vjen në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një magjistrat dhe, si pasojë, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, subjekti ka cenuar besimin e publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit

¹⁹ Paragrafët 29.23 - 29.26, të vendimit të Komisionit.

nr. 84/2016. Në përfundim, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk mbulon me burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “DaimlerChrysler”, me targë {***}, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

17.2. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk mbulon me burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “DaimlerChrysler”, me targë {***}, si dhe ka cenuar besimin e publikut me anë të veprimeve juridike fiktive/të simuluar për rritjen e çmimit të shitjes së mjetit tjetër, që ka shërbyer si burim financimi për këtë automjet, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

17.3. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, gjatë gjykimit në Kolegj, prapësoi se pretendimi i Komisionerit Publik mbështetet në një interpretim të ngushtë të provave, po aq sa edhe paragjykes në drejtim të vlerësimit të drejtë të fakteve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit. Subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim, si edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, të paraqitura në Komision, duke theksuar gjendjen e mjetit tip “Mercedes-Benz”, në momentin e blerjes, në vitin 2005, si dhe investimet e kryera prej tij për përmirësimin e gjendjes së mjetit. Subjekti i rivlerësimit ka çmuar me vlerë të veçantë provuese shkresën e datës 10.01.2026, e paraqitur prej tij dhe e administruar në cilësinë e provës gjatë gjykimit në Kolegj. Kjo shkresë është lëshuar nga z. A. Z., administrator i aktivitetit privat “{***}”, në Levan, Fier. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, sipas deklaramit të z. Z., konfirmohen standardet reale të tregut për periudhën 2005 – 2007, lidhur me automjetet tip “Benz 200 D” dhe pjesët e tyre përbërëse, ku një motor i përdorur për këtë mjet tregtohej në intervalin 80.000 – 100.000 lekë, ndërsa një motor kondicioneri në vlerën rreth 20.000 – 30.000 lekë. Këto çmime, sipas subjektit të rivlerësimit, përputhen plotësisht me natyrën dhe shkallën e investimeve të kryera prej tij në automjetin në fjalë. Subjekti i rivlerësimit ka nënvizuar vlefshmërinë faktike dhe ligjore të kontratës noteriale të shitjes, e cila provon realitetin e transaksionit sipas Kodit të Procedurës Civile. Nuk ka ekzistuar asnjë detyrim ligjor për deklaramin e këtyre shpenzimeve, përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të miratuara në vitin 2012, kur u vendos pragu prej 500.000 lekësh për shpenzimet e deklarueshme. Në mungesë të një baze ligjore për deklaramin apo arkivimin e këtyre investimeve, mungesa e dokumentacionit financiar nuk mund të interpretohet në dëm të subjektit të rivlerësimit, aq më tepër kur shpenzimet janë provuar me deklarime të shërbimeve nga subjektet përkatëse që kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me automjetin.

17.4. Në analizë të shkakut të ankimit si më sipër, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit në vendim, se vlera e shitjes automjetit tip “Mercedes-Benz”, në shumën 1.000.000 lekë, në vitin 2009, në raport me vlerën e blerjes së tij, prej 250.000 lekësh, në vitin 2005, është jashtë logjikës financiare, sipas së cilës një mjet që përdoret, amortizohet dhe, për pasojë, nuk mund të shitet më shtrenjtë, ka ardhur si pasojë e pamundësisë së subjektit të rivlerësimit për të provuar shpenzimet e kryera të pretenduara si investime për rritjen e vlerës së automjetit, gjatë hetimit administrativ në Komision.

17.5. Në favor të arsytimit të Komisionit, për të konsideruar si vlerë të përfituar nga subjekti i rivlerësimit, nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, vetëm shumën prej

250.000 lekësh, sa ka qenë vlera e shpenzuar për blerjen e mjetit, trupi gjykues vlerësoi edhe faktin se, dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion të kohës shpenzimet apo investimet e kryera për rritjen e vlerës së automjetit, si pasojë e të cilave arriti ta shiste atë me një çmim 4 herë më të lartë se çmimi i blerjes, megjithëse ky automjet kishte qenë në përdorim për rreth 4 vite pas datës së blerjes, e për pasojë, edhe është amortizuar gjatë kësaj periudhe. Shkresa e datës 10.01.2026, e administratorit të aktivitetit privat “{***}”, në Levan, Fier, përmban informacion rreth çmimit të përafërt të shitjes së pjesëve të këmbimit për automjetet tip “Mercedes-Benz”, në periudhën 2005 – 2007, por nuk provon se pikërisht ky ka qenë çmimi që ka paguar subjekti i rivlerësimit për vendosjen e këtyre pjesëve në automjetin në pronësi të tij. Trupi gjykues vëren se, edhe në rast se konsiderohen këto vlera, përsëri çmimi i shitjes së mjetit, prej 1.000.000 lekësh, krahasuar me vlerën e blerjes së tij, prej 250.000 lekësh, dhe investimit prej 130.000 lekësh, nuk duket të jetë në kushtet e një logjike normale financiare.

Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të drejtë vlerësimin e Komisionit dhe pretendimin e Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, për të përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme, për blerjen e automjetit tip “DaimlerChrysler”, vetëm vlerën prej 250.000 lekësh, nga vlera e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj u konfirmua rezultati i arritur nga Komisioni në vendim,²⁰ se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 559.230 lekë, për blerjen e automjetit tip “DaimlerChrysler”, me targë {***}, në vitin 2009, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

17.6. Sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se çmimi i shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në vlerën 1.000.000 lekë, nga subjekti i rivlerësimit, duket të jetë në kushtet e një veprimi juridik fiktiv/i simuluar, që vjen në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një magjistrat dhe, si pasojë, subjekti ka cenuar besimin e publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren se çështja e analizuar më sipër në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë, e cila është konsideruar se përbën shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për këtë kriter, është vlerësuar po ashtu se përbën bazë për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti gjendet gjithashtu, për të njëjtat shkaqe, edhe në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që shkakton vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në vijimësi të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, lidhur me aplikimin e nenit të sipërcituar, përderisa në rastin objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerësoi se mangësitë e konstatuara në vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli janë të tilla që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, e për rrjedhojë, së bashku me konkluzionet e tjera për mungesë të burimeve financiare të ligjshme kualifikohen sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe për pasojë ai nuk mund të ndodhet edhe në kushtet e cenimit të besimit të publikut sipas pikës 5 të po këtij neni, për të njëjtat problematika, duke e ndëshkuar në këtë mënyrë dy herë për të njëjtën shkelje, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të së drejtës.

Lidhur me sjelljen e subjektit të rivlerësimit, të kontestuar nga Komisioneri Publik dhe përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues nënvizon se, në konsideratë të veprimeve

²⁰ Paragrafi 29.25 - 29.26, i vendimit të Komisionit.

juridike të ndërmarra prej tij, nuk i rezulton që ai (subjekti) të ketë treguar ndër vite, një mënyrë sjelljeje të përsëritur apo të orientuar drejt pretendimit për blerje me çmim të lirë dhe shitje me çmim më të shtrenjtë për pasuritë e tij, qofshin ato të luajtshme apo të paluajtshme, në funksion të justifikimit të shpenzimeve të kryera/dokumentuara. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi të konsiderojë këtë sjellje të pamjaftueshme për të sjellë peshë të posaçme në vlerësimin tërësor, për të konkluduar sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

18. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 559.230 lekë, për blerjen e automjetit tip “DaimlerChrysler”, në vitin 2009, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
19. Komisioneri Publik ka parashtruar se, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, shkaqet e trajtuara në ankim, si dhe pamjaftueshmëritë e konstatuara nga Komisioni për vitet 2006 dhe 2016, çojnë në një rezultat financiar negativ, që tejkalon dhe nuk justifikon zbatimin e parimit të proporcionalitetit, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3, lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Ky qëndrim u konfirmua edhe nga përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare.

19.1. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke parashtruar se në analizën financiare të kryer nga Komisioni, për vitin 2016, nuk është marrë në konsideratë kronologjia reale e disponimit të likuiditeteve në *cash* dhe mënyra faktike e përdorimit të tyre.

Subjekti rivlerësimit ka argumentuar se në deklaratën periodike të interesave të vitit 2015 ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 200.000 lekë. Në periudhën 11.02.2015 – 29.12.2015, nga llogaria e pagës pranë Intesa Sanpaolo Bank ka tërhequr shumën 340.000 lekë, e cila është mbajtur në banesë gjatë vitit 2015 dhe është përdorur më tej për shpenzime në vitin 2016.

Në mars të vitit 2016, kur ka plotësuar deklaratën e interesave periodikë vjetorë të vitit 2015, gjendja e likuiditeteve *cash* të disponueshme ka qenë 200.000 lekë, pasi shuma prej 340.000 lekësh është përdorur për shpenzimet e domosdoshme në muajt e parë të vitit 2016.

19.2. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit e ka ngritur edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, lidhur me balancën negative prej (-) 134.916 lekësh, të konstatuar në analizën financiare të vitit 2016. Komisioni në vendim²¹ ka arsyetuar se: “Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se është një pakujdesi e tij në deklarimin e gjendjes *cash* për vitin 2015, trupi gjykues çmon se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, për sa kohë saktësia dhe plotësia e deklaramit për këtë likuiditet matet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe nuk mund të prezumojë të kundërtën, duke rikonstatuar se mungesa e burimeve të ligjshme në shumën 134.916 lekë mbetet e pandryshuar, e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesin e rivlerësimit për këtë subjekt”.

²¹ Paragrafi 31.11, i vendimit të Komisionit.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike të interesave, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e vitit 2015, ka deklaruar gjendje likuiditetesh në *cash*, në shumën 200.000 lekë, ndërsa në deklaratën e vitit 2016 nuk ka deklaruar disponim të këtyre likuiditeteve. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të drejtë arsyetimin e Komisionit në vendim, si cituar më sipër, si dhe reflektimin e tij në analizën financiare të vitit 2016, duke pakësuar likuiditetin në *cash* në shumën 200.000 lekë. Për pasojë, mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, në shumën (-) 134.916 lekë, për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2016, mbetet e pandryshuar edhe në Kolegj.

19.3. Mungesa e burimeve të ligjshme financiare, e rezultuar nga analiza financiare për vitin 2006, u vlerësua nga trupi gjykues si një vlerë e papërfillshme, për t'u konsideruar në vlerën totale të mungesës së burimeve financiare të subjektit të rivlerësimit.

20. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, mungesat e burimeve të ligjshme financiare për ndërtimin e katit të parë të banesës dy kate, në {***}, Fier, në vitin 2008, për blerjen e automjetit në vitin 2009, si dhe për përballimin e shpenzimeve të vitit 2016, në shumën totale (-) 1.535.648 lekë, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, u vlerësuan nga trupi gjykues si të pamjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i Kolegjit mbi shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të figurës

21. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit: *problematikat e adresuara nga hetimi administrativ i kryer në Komision, në lidhje me kriterin e figurës, duhet të merren në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues konstatoi si më poshtë:

21.1. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, në vendim²², arriti në përfundimin se: *“Në analizë të deklarimeve të subjektit dhe shtetasve S. M. dhe O. M., në raport me tërësinë e fakteve të dala gjatë hetimit, trupi gjykues çmon se në këtë rast, ‘Njohja nën rrethanat e paraqitura apo të pretenduara nga subjekti si njohje jo e drejtpërdrejtë’, nuk mund t’i vishet subjektit si një veprim i hamendësuar apo të merret apriori për ta kualifikuar atë si një marrëdhënie shoqërore me një njohje të hershme të vazhdueshme, apo vetëm për marrjen e automjetit në përdorim. Nga ana tjetër, edhe kontrata e nënshkruar mes palëve, për përdorimin e automjetit në vitin 2014, ka ardhur si detyrim ligjor, të cilin subjekti e ka përmbushur, për të lëvizur me një automjet që nuk e kishte në pronësinë e tij, e ka deklaruar në pyetësonin standard për efekt të këtij procesi, konfirmuar përmes deklaramit të tij nga shtetasi O. M., po për efekt të këtij procesi, ku subjekti ndodhet në të njëjtën rrethana që fakti i dënimit të këtij shtetasi nuk ishte i njohur, pra i dokumentuar nga autoritetet përkatëse, apo i publikuar nga media për procedime apo dënime të këtij shtetasi. Pavarësisht kohës së shtrirjes së kontratës me afat njëvjeçar, për të cilën subjekti e pretendon si një ‘akt standard’, trupi gjykues, në mungesë të të dhënave të këtij dyshimi apo të mungesës së evidentimit të kontakteve të tjera vazhduese, konstaton se përsëri kjo periudhë nuk plotësohet me konfirmimin e hetimeve/dënimeve të këtij shtetasi, ku dijenia mbetet një rrethanë e panjohur dhe objektivisht e*

²² Paragrafi 41.35 - 41.38 i vendimit të Komisionit.

pamundur për t'u diktuar nga trupi gjykues në adresë të subjektit. Nën këtë arsyetim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se nuk u provuan kushte apo rrethana, të cilat në kuptim të Kreut V të ligjit nr. 84/2016, apo specifikisht të nenit 38 të po këtij ligji, e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe nuk mund të arrijë në një konkluzion tjetër, përveçse ai ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës 'b', të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është çmuar edhe në raport me të dhënat negative të konfirmuara nga organet ligjzbatuese që lidhen me verifikimin e kontrollit të figurës apo me mungesën e të dhënave të tjera përgjatë hetimit lidhur me figurën e subjektit. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se, për sa kohë provat dhe rrethanat e kësaj çështjeje nuk ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, nuk evidentohen elemente të tilla të arsyeshme, të konsiderueshme apo të perceptueshme, për t'i kualifikuar si cenim të besimit të publikut, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.

21.2. Në kundërshtim të përfundimit si më sipër, Komisioneri Publik ka parashtruar në argumentimin e shkakut të ankimit, se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, se lidhur me procedimin penal të shtetasit S. M. është njohur nga rezultatet e hetimit të dërguara me *email*-in e datës 14.05.2024, nga Komisioni, nuk është i besueshëm, vlerësuar me rrethanat e parashikuara sipas pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, nga përmbajtja e deklaratës noteriale, datë 08.01.2021, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit e ka njohur vetë z. S. M., të paktën që nga viti 2014 dhe jo nëpërmjet shtetasit O. M. Bazuar në rrethanën e faktit të njohjes reciproke, ata kanë shkëmbyer mjetet me njëri-tjetrin. Komisioneri Publik ka vlerësuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, se është njohur për procedimin penal të shtetasit S. M. vetëm nga rezultatet e hetimit, e më pas përpjekja e tij për ta paraqitur kontaktin si njohje jo e drejtpërdrejtë e tij, por e mikut të tij, O. M., dhe si kontakt rastësor, nuk është i besueshëm dhe nuk mbështetet në gjendjen faktike të akteve në dosje dhe, në thelb, është një përpjekje e subjektit të rivlerësimit për të fshehur marrëdhënien me këtë shtetas, në kuptim të nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës. Sa më lart, sipas Komisionerit Publik, duhet të merret në konsideratë në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 84/2016.

21.3. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në shqyrtimin e çështjes në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim.

21.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, pretendoi se, referuar parashikimeve të kuadrit ligjor të procesit të rivlerësimit, logjika e argumentimit në rastin konkret përjashton ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm, pasi:

Së pari, referuar dokumentacionit zyrtar të administruar nga Komisioni, rezulton e provuar se procedimi penal ndaj shtetasit S. M., për qëllim ekstradimi, në funksion të një vendimi gjyqësor italian, të vitit 2002, është regjistruar vetëm në vitin 2021. Ndërkohë, deklarata e figurës është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në janar të vitit 2017, pra katër vite përpara regjistrimit të këtij procedimi. Në këto rrethana objektive mungon çdo bazë faktike dhe ligjore për të pretenduar dijëni apo detyrim deklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit në një moment, kur juridikisht nuk ekzistonte asnjë procedim penal i regjistruar ndaj shtetasit S. M. në Shqipëri.

Së dyti, kuadri ligjor i rivlerësimit përcakton qartë se kontrolli i figurës bazohet në deklaratën e subjektit të rivlerësimit dhe në prova të tjera konkrete, nga të cilat provohet tej çdo dyshimi, se subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në rastin

konkret nuk ekziston asnjë provë e tillë dhe nuk ka asnjë fakt që të dëshmojë se kontakti i pretenduar ka qenë i qëllimshëm, i vazhdueshëm, apo i lidhur me ushtrimin e detyrës si prokuror.

Së treti, rrethanat faktike të kontaktit të vetëm të ndodhur në vitin 2014, përdorimi për disa ditë i një automjeti, përmes ndërmjetësimit të një miku të përbashkët, nuk përmbushin asnjë nga elementet e kontaktit të papërshtatshëm. Ky kontakt ka qenë rastësor, i kufizuar në kohë, pa karakter të qëllimshëm dhe plotësisht i shkëputur nga ushtrimi i funksionit publik.

Së katërti, mungesa e çdo dijenie nga ana e subjektit të rivlerësimit për ndonjë rekord penal të shtetasit S. M., kombinuar me faktin se procedimi penal ndaj tij është regjistruar shumë vite më vonë, përjashton çdo element subjektiv të qëllimit për fshehje apo deklaram të pasaktë. Në këto kushte, nuk mund të ngrihet as prezumimi ligjor i parashikuar nga neni Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, pasi mungojnë kushtet që e aktivizojnë atë.

Kërkesa e subjektit të rivlerësimit për lëshimin e deklaratës noteriale nga z. M. është bërë përpara nisjes së procedimit penal për ekstradim, në një kohë kur subjekti nuk kishte asnjë dijeni reale apo të mundshme mbi ekzistencën e një dënimi penal të tij në shtetin italian, fakt që provohet edhe nga mungesa e çdo të dhëne në regjistrat shqiptarë, deri në atë moment. Qasja e Komisionerit Publik, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dijeni mbi lajmet e bëra publike apo mbi faktin se ky shtetas ka qenë i proceduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, presupozon në mënyrë të pajustificuar një detyrim abstrakt vigjilence dhe një interes personal për të ndjekur apo verifikuar situatën penale të një personi, me të cilin nuk ka pasur njohje të drejtpërdrejtë, marrëdhënie shoqërore, profesionale apo funksionale. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë as prokuror i çështjes, as pjesë e trupës proceduese, nuk ka pasur akses institucional në dosje dhe nuk ka ushtruar asnjë funksion, që t'i jepte pozitë të privilegjuar në raport me informacionin dhe nuk ka pasur asnjë arsye ligjore apo faktike për të ushtruar interes apo verifikim për këtë shtetas. Subjekti i rivlerësimit referoi se qasja e tij gjen mbështetje të plotë në jurisprudencën e Kolegjit, konkretisht në vendimin nr. 15/2025 (JR), sipas të cilit, nga Kolegji është çmuar se dyshimi për dijeninë e subjektit në mungesë të provës, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, nuk mund të interpretohet në disfavor të tij.

Subjekti i rivlerësimit pretendoi se shkak i ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës nuk gjen mbështetje në kuadrin ligjor, as në provat e administruara dhe as në praktikën e konsoliduar të Kolegjit, për pasojë duhet të rrëzohet si i pabazuar.

21.5. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pasi u njoh me pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në parashtrime, në fazën e bisedimeve përfundimtare, vlerësoi se evoluimi i jurisprudencës së Kolegjit në drejtim të kriterit të kontrollit të figurës ndikon në këtë shkak ankimor, duke e konsideruar të shëruar atë. Për sa i përket qasjes së subjektit të rivlerësimit në kontaktin me shtetasin S. M., mbetet sikurse parashtruar në ankimin e datës 04.10.2024, por pa ndikim në këtë shkak.

- 22.** Në kushtet kur në konkluzionet përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme potencoi se shkak i ankimit për kriterin e kontrollit të figurës u konsiderua i shëruar, trupi gjykues vlerësoi se ai mbeti jashtë objektit e kufijve të shqyrtimit të çështjes, e për pasojë, nuk iu nënshtrua vlerësimit përfundimtar.

D. Vlerësimi i Kolegjit mbi shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

23. Trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, në përfundim të hetimit administrativ, në vendim²³, ka arritur në konkluzionin se: “[...] Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe duke marrë në konsideratë: (i) numrin e çështjeve të analizuara, ku janë konstatuar mangësi në aspektin e aftësive profesionale në raport me çështjet e ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, dhe ato të analizuara nga denoncimet; (ii) mangësia e konstatuar si më lart nuk gjendet e përsëritur në mënyrë të vazhdueshme, që të përfaqësojë defekte të rëndësishme dhe të mjaftueshme për njohuritë profesionale; (iii) kërkesat e shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet: ‘[...] kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale [...]’ - vlerëson se problematika e rezultuar në rivlerësimin e aftësive profesionale [...] nuk plotëson kushtin e parashikuar nga pika 4, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet ‘i papërshtatshëm’”.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, çmoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, dhe për këtë shkak konsiderohet “i aftë”.

23.1. Komisioneri Publik, në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm, ka pretenduar në ankim se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës së kaluar nga Komisioni për disa çështje penale, duke treguar mangësi, sipas parashikimeve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), të cilat duhet të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

23.2. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoi se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, mbeti e provuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra e vendime, në aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 84/2016, të cilat duhet të konsiderohen në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

23.3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegji, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, pretendoi se shkaku ankimit të Komisionerit Publik, që ka të bëjë me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, është i pabazuar në planin ligjor dhe në analizën faktike të çështjeve konkrete. Standardi i kërkuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016, lidhet me mangësi serioze, të dukshme dhe të përsëritura, që cenojnë thelbësisht ushtrimin e funksionit dhe jo me vlerësime retrospektive të rezultateve procedurale apo me dallime interpretimi ndërmjet organeve të ndryshme të drejtësisë.

²³ Paragrafët 48-48.2, të vendimit të Komisionit.

24. Pasi analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, pretendimet e Komisionerit Publik, përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si më poshtë.
25. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit: *Në kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. {***}, të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka treguar të meta në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, në kuptim të parashikimit të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016*, trupi gjykues analizoi sa vijon.
26. Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, lidhur me procedimin penal nr. {***}/2015²⁴, trupi gjykues vëren se:

26.1. Në datën 15.11.2015, nga forcat e Komisariatit të Policisë Fier është arrestuar në flagrancë shtetasi J. XH., pa leje drejtimi për motor, duke drejtuar motomjetin e markës “Lancin”, pa targë, me vende 1+1, me fuqi 110 cc. Nga këqyrja e motomjetit për të identifikuar karakteristikat e tij, ka rezultuar se ai ishte një ciklomotor, me fushë kilometrike 160 km/orë dhe fuqi motorike LM 110-15. Sipas informacionit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Fier ka rezultuar se i dyshuari është i pajisur me leje drejtimi për drejtim automjeti, kategoria “B”. Në këto kushte, Komisariati i Policisë Fier ka përcjellë materialet hetimore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

26.2. Subjekti i rivlerësimit, në datën 16.11.2015, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}/2015, për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit J. XH.

26.3. Me kërkesën që mban datën 17.11.2015, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga gjykata vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal, “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, ndaj këtij shtetasi.

26.4. Sipas përmbajtjes së procesverbalit “Për deklarimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet”, datë 15.11.2015, shtetasi J. XH ka pranuar se nuk është i pajisur me leje drejtimi për motomjete. Këtë deklaram, ai e ka bërë edhe në datën 24.11.2015, pasi është njoftuar nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me ushtrimin e të drejtave që gëzon, por edhe në lidhje me akuzën në ngarkim të tij.

26.5. Më datë 24.11.2015, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për dërgimin për gjykim të çështjes penale ndaj të pandehurit J. XH, për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

26.6. Me vendimin e datës 04.12.2015, të Drejtuesit të Prokurorisë, subjekti i rivlerësimit është zëvendësuar nga një prokuror tjetër dhe ky i fundit ka përfaqësuar organin e akuzës në gjykim. Prokuroja e çështjes, në diskutimin përfundimtar të datës 08.06.2016, ka kërkuar pushimin e çështjes penale me arsyetimin se, gjatë gjykimit, është kryer akti i ekspertimit autoteknik dhe ka rezultuar se

²⁴ Evidentuar si çështje nga Komisioni, pas verifikimit të të dhënave të dokumentit ligjor nr. 5, si një nga 5 dosjet e përzgjedhura me short, referuar në rubrikën përkatëse të “Raportit të KLP-së, për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj”, nr. {***} prot., datë 10.07.2023.

motomjeti, që drejtohej nga i pandehuri, kërkon leje drejtimi të kategorisë “B”, të cilën i pandehuri e disponon dhe, sipas përcaktimeve në fuqi të Kodit Rrugor, fakti nuk parashikohet si vepër penale.

26.7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. {***}, datë 08.06.2016, ka vendosur pushimin e çështjes penale dhe heqjen e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, të shtetasit J. XH. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, në datën 21.06.2016.

26.8. Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, ka konstatuar:

Neni 291 i Kodit Penal parashikon se: “Drejtimi i automjeteve apo i mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet”. Neni 291 i Kodit Penal është një dispozitë blanketë, pasi për zbatimin e tij kërkohet referimi në Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Referuar dispozitës së mësipërme, një nga elementet e anës objektive të kryerjes së veprës penale të sipërcituar është drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara pa dëshminë përkatëse. Në kohën kur është kryer arrestimi në flagrancë i të pandehurit (në datën 15.11.2015), në fuqi ishte ligji nr. 175/2014, “Për disa ndryshime në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë” (i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 203, datë 31.12.2014), i cili në shtesat dhe ndryshimet që i ka bërë neneve të Kodit Rrugor, përkatësisht në nenin 115, pika 3, parashikon se: “Në kategorinë ‘A1’ futen motomjetet deri në 125 cc dhe me fuqi 11 kw”. Më tej, në nenin 123, pika 2, në shkronjat ‘dh’ dhe ‘ë’, parashikon se leja e drejtimit e dhënë për kategorinë ‘B’ është e vlefshme për kategoritë ‘A1’, nëse individ i është mbi moshën 21 vjeç”. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore rezulton se DPSHTRr-ja Fier, me shkresën e datës 16.11.2015, ka informuar Komisaratin e Policisë Fier se shtetasi J. XH rezulton i pajisur me leje drejtimi automjeti të kategorisë “B”. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik, për të përcaktuar karakteristika e motomjetit, por konstatohet vetëm akti i këqyrjes së motomjetit, i cili ka konstatuar se motomjeti ka fuqi motorike LM 110-15. Në gjykim është kryer akti i ekspertimit autoteknik dhe ka rezultuar se motomjeti i të pandehurit është me fuqi motorike 110 cc. Gjithashtu, sipas certifikatës personale, i pandehuri është i datëlindjes 08.08.1983 dhe, për pasojë, në kohën kur është ndaluar ka qenë mbi 21 vjeç (ka qenë 32 vjeç). Sa më sipër, duket se në rastin konkret nuk plotësohet elementi i anës objektive të veprës penale, pasi motomjeti ka rezultuar me fuqi 110 cc, si dhe i pandehuri nuk mund të konsiderohet subjekt i veprës penale, sepse ka rezultuar se është i pajisur me leje drejtimi për motomjetin përkatës dhe është mbi moshën 21 vjeç. Neni 2 i Kodit Penal parashikon se: “Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale”. Në vijim, neni 290 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur: ç) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston”. Në përfundim, duket se: (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk ka urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik të motomjetit të sekuestruar, për të përcaktuar karakteristikat e tij lidhur me fuqinë motorike. (ii) Subjekti i rivlerësimit ka marrë në përgjegjësi penale shtetasin J. XH për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga nenin 291 i Kodit Penal, në kushtet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. (iii) Subjekti i rivlerësimit ka marrë në përgjegjësi penale shtetasin J. XH, duke moszbatuar parimin e ligjshmërisë, të parashikuar nga neni 2 i Kodit Penal. Për

sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

26.9. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk është dakord me konstatimet e Komisionit, sepse: “Nuk kam urdhëruar kryerjen e një akti ekspertimi autoteknik, pasi nga të dhënat që janë grumbulluar në dosjen hetimore, kanë dalë të qarta dy momente:

a) Në shkronjën ‘dh’, të pikës 2, të nenit 123, të Kodit Rrugor përcaktohet se: *‘Lejet e drejtimit të dhëna për kategoritë A, B, C ose D janë të vlefshme, përkatësisht, për kategoritë A1 e A2, B1, C1 ose D1’*. Nga formulimi i mësipërm rezulton qartë se leja e drejtimit të kategorisë ‘B’ është e vlefshme vetëm për kategorinë ‘B1’.

b) Motomjeti, që drejtonte i pandehuri J. XH, kërkonte pajisjen e tij me leje drejtimi të kategorisë ‘A1’, e cila, siç evidentohet dhe më sipër, nuk përfshihet si e vlefshme për lejet e drejtimit të kategorisë ‘B’.

Dua të evidentoj edhe faktin se në gjykimin e çështjes ka qenë tjetër prokuror”.

26.10. Në vendim,²⁵ Komisioni ka arsyetuar: “Trupi gjykues konstaton se duket se subjekti ka proceduar me dërgimin e shpejtë të kërkesës drejtuar gjykatës për gjykimin e çështjes, çështje e cila është përfaqësuar në gjykim nga organi i akuzës nga një subjekt tjetër rivlerësimi, duke u mjaftuar me ekzistencën e fakteve të dala, si: (i) fakti që i dyshuari nuk ka disponuar dokumentin e drejtimit të motorit në momentin e kapjes në flagrancë; (ii) fakti që institucioni përgjegjës nuk ka konfirmuar leje drejtimi për mjetin me të cilin është kapur i dyshuari në flagrancë; (iii) fakti që mjeti nuk ka qenë në emër të këtij shtetasi, por edhe vetëdeklarimi i të pandehurit, se nuk dispononte leje drejtimi për motomjet. Por, në aplikim të kërkesave të nenit 123, pika 2, shkronjat ‘dh’, ‘e’ dhe ‘ë’ të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, Kodi Rrugor, i ndryshuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka munguar në ndërmarrjen e veprimit hetimor, sikurse ishte mos kryerja e aktit të ekspertimit për të konkluduar mbi vlefshmërinë e lejes së drejtimit, që dispononte shtetasi J. XH edhe për motomjet, akt i cili u krye nga gjykata. Mbi këto fakte e rrethana, trupi gjykues çmon se subjekti shfaq mangësi sipas nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016”.

27. Komisioneri Publik në ankim ka parashtruar se bashkohet me qëndrimin e Komisionit të pasqyruar në vendim, duke u fokusuar në arsyetimin që Komisioni ka parashtruar në rezultatet e hetimit administrativ.

27.1. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrime, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik lidhur me këtë procedim penal, ndërsa në konkluzionet përfundimtare parashtroi se, edhe në përfundim të gjykimit në Kolegj, shkaku ankimor qëndron. Si rrjedhojë e moskryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore, subjekti i rivlerësimit ka marrë në përgjegjësi penale shtetasin J. XH, në kushtet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, duke cenuar parimin e ligjshmërisë së parashikuar nga neni 2 i Kodit Penal.

27.2. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, potencoi se neni 123, pika 2, shkronja “dh” e Kodit Rrugor parashikonte shprehimisht se lejet e drejtimit të dhëna për kategoritë “A”, “B”, “C” ose “D” janë të vlefshme përkatësisht vetëm për nënkategoritë “A1/A2”, “B1”, “C1” ose “D1”. Nga formulimi i kësaj dispozite rezulton pa asnjë paqartësi se leja e drejtimit e kategorisë B është e

²⁵ Paragrafët 42.5.8 - 42.5.9, të vendimit të Komisionit.

vlefshme vetëm për kategorinë “B1” dhe nuk shtrihet automatikisht në kategoritë e tjera të mjeteve, pavarësisht moshës apo përvojës së drejtuesit të mjetit. Në rastin konkret, të dhënat teknike të motomjetit, të administruara në dosjen hetimore, tregojnë se bëhej fjalë për një motomjet që kërkonte pajisjen me leje drejtimi të kategorisë “A1” ose më të lartë, kategori që nuk përfshihet në asnjë rast në vlefshmërinë e lejes së drejtimit të kategorisë “B”. Edhe nëse do të ishte kryer ekspertimi autoteknik në fazën e hetimit, rezultati i tij nuk do të kishte ndryshuar në mënyrë thelbësore vlerësimin juridik të çështjes, pasi karakteristikat teknike të mjetit e vendosnin atë jashtë kategorive të lejuara për mbajtësit e lejes së drejtimit të kategorisë “B”. Ligji procedural penal nuk i imponon prokurorit detyrimin për të kryer çdo veprim hetimor të mundshëm, por vetëm ato veprime që janë të domosdoshme dhe proporcionale për zbardhjen e çështjes. Gjykata në fazën e gjykimit ka të drejtë dhe detyrimin të thellojë hetimin, nëse e çmon të nevojshme, por kjo nuk do të thotë se prokurori ka gabuar duke mos e kryer të njëjtin veprim në fazën e hetimit paraprak. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlerësimi i Komisionerit Publik, se ka shfaqur të meta në aspektin e njohurive ligjore dhe ka cenuar parimin e ligjshmërisë, nuk gjen mbështetje as në analizën e plotë të fakteve, as në standardin ligjor të vlerësimit të aftësive profesionale.

Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti Aktin e Ekspertimit Autoteknik, të vitit 2026, sipas të cilit, referuar llogaritjeve analitike, rezultoi se që të arrihet një shpejtësi e rendit 160 km/orë, kërkohet një fuqi e motorit rreth 34.239 kw dhe, bazuar në kërkesat e Kodit Rrugor, neni 115, pika 1 e tij, për fuqi më të mëdha se 15 kw, kërkohet leje drejtimi kategoria “A”.

28. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se, në momentin që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për gjykimin e procedimit penal objekt kontrolli, drejtimi i motomjetit në rrethanat konkrete të pasqyruara më sipër në këtë vendim, përbënte ende vepër penale. Ndryshimet e Kodit Rrugor lidhur me lejet e drejtimit për këtë kategori motomjetesh, rezultoi të kenë hyrë në fuqi më datë 15.01.2016, dy muaj pasi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për gjykimin e procedimit penal për të pandehurin, në datën 24.11.2025. Procedimi penal nr. {***}/2015, për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit J. XH, është regjistruar nga subjekti i rivlerësimit në datën 16.11.2015, pasi në datën 15.11.2015, ky shtetas është arrestuar në flagrancë nga forcat e Komisarariatit të Policisë Fier. Të gjitha këto veprime janë kryer nga subjekti i rivlerësimit përpara afatit kohor kur hynte në fuqi neni 13 i ligjit nr. 175/2014, “Për disa ndryshime në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, që në dispozitën kalimtare parashikoi hyrjen në fuqi të kësaj dispozite, 12 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit/ndryshimeve²⁶.

28.1. Trupi gjykues çmoi të nënvizojë faktin e rezultuar nga hetimi administrativ, se në momentin e gjykimit të çështjes, në qershor 2016, ndryshimi në dispozitën e sipërcituar të Kodit Rrugor kishte hyrë në fuqi, por subjekti i rivlerësimit ishte zëvendësuar nga një prokuror tjetër.

28.2. Nga sa më sipër, rezultoi që subjekti i rivlerësimit e ka zbatuar drejt dispozitën ligjore, pasi në momentin kur ai ka marrë vendimin, për motomjetet me fuqinë ciklomotore në fashën e të cilave përfshihej edhe ai i drejtuar nga i pandehur, ishte ende në fuqi dispozita e Kodit Rrugor, që

²⁶ Ligji nr. 175/2014, “Për disa ndryshime në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 203, datë 31.12.2014, në shtesat dhe ndryshimet që i ka bërë neneve të Kodit Rrugor, parashikonte në nenin 115, pika 3, se në kategorinë “A1” futen motomjetet deri në 125 cc dhe me fuqi 11 kw. Më tej, në nenin 123, pika 2, në shkronjat “dh”, “ë”, parashikon se leja e drejtimit e dhënë për kategorinë “B” është e vlefshme për kategoritë “A1”, nëse individi është mbi moshën 21 vjeç. Këto ndryshime, sipas parashikimit të nenit 31, me titull “Dispozita kalimtare”, të vetë ligjit nr. 175/2014, hynin në fuqi 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

parashikonte se drejtuesit e këtyre mjeteve duhet të kishin lejen e drejtimit të kategorisë “A1”. Për rrjedhojë, vlerësimi Komisionit dhe pretendimet e Komisionerit Publik dhe të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se subjekti i rivlerësimit ka marrë padrejtësisht të pandehurin në përgjegjësi penale, në kushtet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, nuk është një vlerësim i drejtë.

29. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimet e Komisionerit Publik dhe të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, në kuptim të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, nuk janë të bazuara.
30. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit: *Për kallëzimin penal nr. {***}, të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, në aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi si vijon.*
31. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar prej Komisionit, gjatë hetimit administrativ, për këtë procedim penal,²⁷ trupi gjykues vëren se:

31.1. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier është regjistruar kallëzimi penal nr. {***}, i vitit 2015, sipas materialeve procedurale të dërguara nga Komisariati i Policisë Fier, me kallëzues A. A. dhe të kallëzuar R. A., për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Vetëgjyqësisë”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 150 dhe 277 të Kodit Penal. Kallëzuesi A. A. ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se ka jetuar në një banesë të ndërtuar në vitin 1961, në fshatin {***}, në Fier, së bashku me prindërit dhe vëllain e tij, B. A. Pas martesës së djemve, prindërit e kanë ndarë banesën në mënyrë të barabartë, nga 70 m² secilit. Kallëzuesi ka pretenduar se banesa ku ai ka jetuar, figuron e hedhur në hartë me numër pasurie {***}. Në nëntor 1996, ai është larguar nga kjo banesë dhe nga fshati, për të jetuar me familjen në Tiranë. Pas një viti të largimit të tij nga banesa, kallëzuesi ia ka dhënë me qira nipi të tij, R. A., për shumën prej 20.000 lekësh në vit. Më pas, nipi i tij, me vetëgjyqësi e ka shkatërruar banesën, duke ngritur pretendimin se është e tij, në të vërtetë, ai ka jetuar me qira aty dhe e ka pranuar se banesa është e kallëzuesit. Kallëzuesi ka referuar se me nipin e tij është dhe në një proces gjyqësor, konkretisht për ndarje pasurie, që figuron në hartë me numër pasurie {***}, të cilën Gjykata e Shkallës së Parë Fier ia ka kaluar kallëzuesit dhe ka urdhëruar R. A. të lirojë pronën.

Bashkë me kallëzimin, z. A. A. ka paraqitur edhe aktet:

- Akt i Marrjes së Tokës në Pronësi, nr. {***}, sipas të cilit, familjes së z. A. D. A., nga fshati {***}, Fier, i jepet në pronësi 14,210 m² tokë, nga të cilat 200 m² truall, ky i fundit gjendet në ngastrën me numër pasurie {***}, bashkë me një sipërfaqe “arë”, prej 420 m².

²⁷ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.10.2023, ka përcjellë në Komision dosjen e kallëzimit penal nr. {***}, të vitit 2015.

- Akt ekspertimi, datë 30.01.2014, i ekspertës M. B., inxhinierë gjeodete, nga përmbajtja e të cilit rezulton se ekspertja është thirrur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në cilësinë e ekspertës, në çështjen civile me palë paditës A. A. dhe palë e paditur R. A., me objekt: “Lirim e dorëzim i truallit prej 420 m², me nr. regjistrim akti {***}, në bazë të hartës topografike, me nr. objekti {***}, në {***}, si dhe prishjen e objektit të ndërtuar në të”. Sipas ekspertës, si rezultat i verifikimit në terren dhe studimit të dokumentacionit që ka pasur në dispozicion, ka rezultuar se janë dy prona në pronësi të dy pronarëve, A. A. dhe B. A., të ndodhura në të njëjtën ngastër me nr. {***}, me sipërfaqe të njëjta prone, 420m²+200m². Mbështetur në fragmentin e hartës kadastrale, prona e paditësit A. A. mban nr. {***}, brenda së cilës ndodhet edhe një banesë, me sipërfaqe toke totale 620 m² dhe sipërfaqe banese 77 m². Prona në emër të B. A. dhe R. A., e cila mban nr. {***} pasurie, ka 620 m² sipërfaqe toke dhe 147 m² sipërfaqe banese. Sipas ekspertës, krahasuar me terrenin dhe gjendjen në fakt, pronën me nr. pasurie {***} e shfrytëzon të gjithën shtetasi R. A., ndërsa banesa që ai shfrytëzon është e ndryshme nga ajo me sipërfaqe 77 m², që figuron në hartën e Komunës {***}. Brenda sipërfaqes prej 620 m² ndodhet banesa njëkatëshe, me themele e muraturë tulle, me sipërfaqe 108 m². Duke krahasuar vendndodhjen e banesës sipas fragmentit të hartës kadastrale me gjendjen faktike, reale në terren, ekspertja ka konstatuar se banesa në të cilën jeton i padituri R. A. është një banesë e re, me dimensione dhe sipërfaqe më të madhe se banesa e pasqyruar sipas hartës, që do të thotë se kemi të bëjmë me dy objekte të ndryshme. Në përfundim, ekspertja ka konkluduar se, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, me nr. regjistrimi {***}, në emër të familjes A. D. A., parcela nr. {***}, në fshatin {***}, i përket zonës kadastrale nr. {***}, ka regjimin juridik “tokë arë + truall”, ndërsa sipas formularit nr. 6, ka vetëm shënimin “truall” dhe në këtë formular janë të përcaktuara vetëm regjimi juridik “pemëtore dhe ullinj”, ndërsa toka “arë” nuk është e përcaktuar në asnjë prej këtyre pronave.
- Listë emërore e pronarëve të trojeve dhe të shtëpive, zona kadastrale {***}, me vulën e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, e cila, në numrin rendor {***}, ka përshkrimin: *Pasuria nr. {***}, lloji i pasurisë “arë + truall”, sipërfaqja e truallit 250 m², sipërfaqja e ndërtesës 90 m², në emrin A. D. A.*, ndërsa në numrin rendor {***} ka përshkrimin: *Pasuria nr. {***}, lloji i pasurisë “arë + truall”, sipërfaqja e truallit 250 m², sipërfaqja e ndërtesës 90 m², në emrin R. A.*

31.2. Nga veprimet hetimore të kryera në këtë procedim penal ka rezultuar se:

31.2.1. Referuar procesverbalit “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, datë 28.05.2015 dhe datë 12.06.2015, z. A. A., përpos sa ka parashtruar në kallëzim, ka deklaruar se shtetasi R. A. i ka paguar qiranë për banesën vetëm për një vit, e më pas, nuk ka paguar më, pasi nuk kishte të ardhura, derisa në vitin 2014, banesa është prishur pjesërisht, sepse në vitin 2013 ka filluar procesi gjyqësor mes tyre, i iniciuar nga deklaruesi, me qëllim lirim nga shtetasi R. A., të sipërfaqes së tokës, që deklaruesi e ka fituar me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi. Prishjen e banesës, deklaruesi pretendon se e ka kërkuar edhe në gjykimin civil, por kjo kërkesë nuk është pranuar nga gjykata.

31.2.2. Referuar procesverbalit “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, datë 17.06.2015, shtetasi R. A. ka deklaruar se shtetasi A. A., xhaxhai i tij, ka jetuar familjarisht në fshatin {***} deri rreth viteve 1992 – 1993 e më pas është larguar në Lushnjë, dhe aktualisht jeton në Tiranë. Deri rreth vitit 1990 ka banuar, provizorisht, në të njëjtën banesë me deklaruesin dhe vëllezërit

e tij. Kjo banesë ka qenë në pronësi të babait të tij, B. A., dhe aktualisht është e regjistruar në emër të nënës së tij, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Pasi u largua nga kjo banesë, për një periudhë rreth 2 - 3-vjeçare ka banuar familjarisht në një objekt komune, kopsht, të cilin ia dha komuna si person i pastrehë. Sipas deklaruësit, z. A. A., në fshatin {***}, ka disa parcela të përfituara me ligjin nr. 7501, të cilat janë larg truallit ku deklaruesi dhe vëllezërit e tij kanë banesat. Lidhur me banesën e pretenduar nga z. A. A., deklaruesi shprehet se kjo banesë nuk ka qenë asnjëherë e z. A. A., aktualisht është në pronësi të nënës së tij, dhe ajo banon në një pjesë të saj, pasi pjesa tjetër është bërë e pabanueshme me kalimin e viteve. Sipas deklaruësit, aktualisht me z. A. A., ai dhe vëllezërit e tij janë në proces gjyqësor, pasi ai ka pretendime për sipërfaqen e truallit ku deklaruesi dhe vëllezërit e tij kanë ngritur banesat e tyre dhe këtë sipërfaqe ia kanë blerë z. A. A., por pa dokument. Këtë gjë, z. A. A. tashmë e mohon dhe i padit në gjykata e në prokurori.

31.2.3. Z. D. A., vëllai i të kallëzuarit R. A., ka paraqitur pranë prokurorisë Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, nr. {***}, datë 25.03.1993, sipas të cilit, familjes së z. B. D. A. nga fshati {***}, Fier, i jepet në pronësi 11,281 m² tokë, nga të cilat 200 m² truall, ky i fundit gjendet në ngastrën me numër pasurie {***}, bashkë me një sipërfaqe “arë”, prej 420 m².

31.2.4. Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit, më datë 18.06.2015, ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal nr. {***}, të vitit 2015, për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga nenet 150 dhe 277 të Kodit Penal, pasi, në bazë të nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale, fakti nuk përbën vepër penale, duke arsyetuar:

Në deklaratimet e shtetasve A. A. dhe R. A., pavarësisht se pretendohet nga të dy për pronësi mbi këtë banesë të vjetër, nga asnjë prej tyre nuk u provua me dokumentet e paraqitura pronësia mbi këtë banesë. Pavarësisht se u paraqitën akte të marrjes së tokës në pronësi, të cilat në vetvete pasqyrojnë sipërfaqe toke bujqësore dhe trualli, të trajtuar në favor të familjeve bujqësore, në asnjë prej tyre nuk evidentohet banesa objekt kallëzimi. Kjo banesë pasqyrohet vetëm në aktin e ekspertimit të kryer në funksion të një procesi gjyqësor civil midis tyre, në të cilin evidentohet se banesa ndodhet brenda sipërfaqes së trajtuar në favor të familjes B. A. Pra, është ky proces, i cili fillimisht do të zgjidhë konfliktet e pronësisë midis tyre, si dhe pronësinë e truallit mbi të cilin është ndërtuar kjo banesë. Pronësia mbi banesën është një element i domosdoshëm i figurës së veprës penale të “Shkatërrimit të pronës” apo të “Vetëgjyqësisë”, të pretenduara nga ana e kallëzuesit. Nga sa u trajtua më lart, rezulton se banesa ka qenë e vjetër dhe e amortizuar, pasi është ndërtuar në vitin 1961 dhe, për rrjedhojë, nuk kemi shkatërrim të pronës me dashje, siç pretendohet në kallëzim, dhe në këto kushte nuk do të fillohet ndjekja penale.

31.2.5. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se:

i) Subjekti i rivlerësimit duket se ka marrë vendimin e datës 18.06.2015, për mosfillimin e kallëzimit penal, pa u plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, si vijon: këqyrjen në vend të banesës së pretenduar nga kallëzuesi si e shkatërruar; kryerjen e ekspertimit për përcaktimin nëse banesa e pretenduar nga kallëzuesi është në pronësi të tij dhe nëse kjo banesë ishte shkatërruar si pasojë e amortizimit apo ka pasur ndërhyrje për prishjen e saj.

ii) Duket se konkluzioni i subjektit të rivlerësimit, në vendimin e datës 18.06.2015, për mosfillimin e kallëzimit penal, nuk mbështetet në faktet dhe provat e administruara, nga ku rezulton se kallëzuesi

ka paraqitur AMTP-në dhe listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit {***}, dhe se nuk është provuar në dokumentet e paraqitura pronësia mbi banesën e vjetër objekt kallëzimi.

iii) Duket se përfundimi i subjektit të rivlerësimit, në vendimin e datës 18.06.2015, për mosfillimin e kallëzimit, nuk është i bazuar në ndonjë akt të përgatitur nga ekspertë të fushës, me njohuri të posaçme në fushën e ndërtimit.

iv) Duket se në vendimin e datës 18.06.2015, për mosfillimin e procedimit penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes, në kushtet kur: ndërmjet kallëzuesit dhe të kallëzuarit po zhvillohej një proces gjyqësor civil lidhur me pretendimet e tyre të pronësisë për banesën dhe truallin objekt kallëzimi penal; kallëzuesi ka paraqitur dokumentacionin që vërteton të drejtën e pronësisë së banesës.

v) Sipas aktit të ekspertimit të procesit civil, të paraqitur nga kallëzuesi, banesa e vjetër e pretenduar nga ana e tij ndodhet në kushtet e themeleve, e shkatërruar, dhe pronën e pretenduar nga kallëzuesi e shfrytëzon të gjithën i kallëzuari.

31.2.6. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pretendimet e mësipërme në raportin e Komisionit i vlerësoj të pabazuara, pasi, edhe pas regjistrimit të kallëzimit penal pranë prokurorisë, përveç veprimeve të kryera nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, është urdhëruar kryerja e veprime verifikuese nga ana ime dhe konkretisht:*

1- Janë marrë dhe këqyrur dokumentet përkatëse që kanë lidhje me kallëzimin e pasqyruar me procesverbal, për këqyrje dhe marrje të dokumenteve, datë 12.06.2015.

2- Është pyetur shtetasi A. A., pasqyruar me procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijani për veprën penale datë 12.06.2015.

3- Është pyetur shtetasi R. A., pasqyruar me procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijani për veprën penale datë 17.06.2015.

*Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme verifikuese, unë kam arritur në konkluzionin se duhej të vendosej mosfillimi i procedimit penal për kallëzimin penal nr. {***/2015, si për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150, ashtu edhe për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277, pasi fakti nuk përbën veprë penale. Të gjitha pretendimet e evidentuara në raportin e Komisionit, se unë duhet të kryeja veprime të ndryshme hetimore, në fakt i përkasin procesit civil dhe jo atij penal. Në rastin konkret, kontradikta që kanë patur palët midis tyre po ndiqej civilisht dhe kallëzimi që ka bërë shtetasi A. A. është bërë me qëllimin e vetëm për të rënduar palët e tjera, që ai ishte në konflikt pronësie.*

*Nga sa më sipër kam mendimin se unë, në rastin konkret, kam zbatuar drejt nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. {***/2015. Fakti që vendimi i mosfillimit nuk është ankimuar edhe nga pala kallëzuese, mbështet në rastin konkret vendimin tim të mësipërm.*

31.3. Komisioni, në përfundim të hetimit mbi kallëzimin penal nr. {***}/2015²⁸, të trajtuar nga subjekti i rivlerësimit, në vendim,²⁹ ka konkluduar se: *Trupi gjykues, në analizë të akteve të administruara në dosje, shpjegimeve të subjektit, arsyetimit të vendimit për mosfillimin e kallëzimit penal, datë 18.06.2015, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime verifikuese, sikurse kërkon edhe çështja objekt hetimi, duke marrë deklaratimet e kallëzuesit, si dhe ka pyetur të kallëzuarin R. A., ka administruar gjithashtu edhe akte lidhur me objektin e hetimit, dhe më tej ka konkluduar në këtë vendimmarrje, se fakti nuk përbën veprë penale. Gjithashtu, vendimi arsyeton edhe mbi konfliktin civil pronësor, i cili duket se ka lidhje edhe me çështjen objekt hetimi, por edhe mbi ekspertizën e kryer që në procesin civil. Trupi gjykues vlerëson se çmuarja e rrethanave dhe e fakteve të konkluduara nga subjekti në këtë vendimmarrje gjendet e bazuar në logjikën dhe interpretimin e tij, në raport me kërkesat e nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale, ku rezultojn gjithashtu se kallëzuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe, për rrjedhojë, nuk evidentohen mangësi të tilla, të cilat mund të përbëjnë shkak cenimi të kriterit profesional të subjektit.*

32. Komisioneri Publik, në argumentimin e shkakut të ankimit, ndryshe nga sa ka arritur në përfundim Komisioni, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal:

(i) Për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, pa bërë këqyrjen në vend të banesës së kallëzuesit dhe eventualisht pa kryer aktin e ekspertimit për përcaktimin nëse banesa ishte shkatërruar me kalimin e kohës apo ka pasur ndërhyrje për prishjen e saj. Subjekti i rivlerësimit, vendimin për mosfillimin e procedimit penal, ndërmjet të tjerave, e mbështet në arsyetimin se kallëzuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin e pronësisë mbi banesën e vjetër objekt kallëzimi, ndërsa nga aktet rezultojn se kallëzuesi për vërtetimin e pronësisë ka paraqitur Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, ku pasqyrohet sipërfaqja e truallit, si dhe listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit {***}, ku banesa e kallëzuesit figuron në këtë listë.

(ii) Për veprën penale “Vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, pa analizuar elementet e figurës së veprës penale në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes, si dhe me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë.

(iii) Për sa i përket shpjegimit të subjektit të rivlerësimit, se ka vendosur mosfillimin për shkak se mosmarrëveshja ishte duke u shqyrtuar nga gjykata civile, ky shpjegim nuk mbështetet në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, nenit 70 dhe 71 të tij, ku përcaktohen normat lidhur me efektet e ndërsjella të vendimit penal dhe procedimeve civile dhe administrative me rrjedhoja në hetimin penal.

32.1. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim, ndërsa në konkluzionet përfundimtare vlerësoi se, edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, shkak i ankimit qëndron. Subjekti i rivlerësimit, në

²⁸ Evidentuar si çështje nga Komisioni, pas verifikimit të Raportit të KLP-së, për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj, nr. {***} prot., datë 10.07.2023, të rubrikës “Të dhëna nga burimet arkivore”, si ankesë e z. A. A. (nr. {***} e vitit 2015), i cili ankohet kundër prokurorit Petrit Vukaj, se padrejtësisht ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e tij për prishjen e banesës. Kjo ankesë nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme, duke i bërë të ditur ankuesit se është njoftuar disa herë për t’u paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nuk është paraqitur. Gjithashtu, i është ridërguar një kopje e vendimit të mosfillimit, duke i bërë të ditur të drejtën e ankimit në gjykatë.

²⁹ Paragrafi 44.4, i vendimit të Komisionit.

vendimin e datës 18.06.2015, ka arritur në përfundimin për veprën penale “Vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, pa analizuar elementet e figurës së veprës penale në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes. Për sa i përket shpjegimit se ka vendosur mosfillimin për shkak se mosmarrëveshja ishte duke u shqyrtuar nga gjykata civile, ky shpjegim nuk mbështetet në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, nenit 70 dhe 71 të tij, ku përcaktohen normat lidhur me efektet e ndërsjella të vendimit penal dhe procedimeve civile dhe administrative me rrjedhoja në hetimin penal.

32.2. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në kundërshtimin e shkakut të ankimit argumentoi, në mënyrë të përmbledhur, se veprimet hetimore të kryera prej tij kanë shërbyer për të sqaruar natyrën reale të konfliktit ndërmjet palëve dhe për të vlerësuar nëse faktet e kallëzuara përmbushnin elementet e ndonjë vepre penale. Problematikat e evidentuara në kallëzim i përkisnin sferës së marrëdhënieve civile dhe ky vlerësim është bërë duke pasur parasysh edhe faktin se palët ndodheshin tashmë në një proces civil për të njëjtën situatë faktike, çka përjashtonte ndërhyrjen e mekanizimit penal. Banesa në fjalë ishte ndërtuar në vitin 1961 dhe aktet verifikuese kanë treguar se dëmtimet e konstatuara në të ishin të vjetra dhe nuk mund t’i atribuoheshin ndonjë veprimi të kohëve të fundit apo sjelljeje penalisht të ndëshkueshme. Sa i përket veprës penale “Vetëgjyqësia”, sipas subjektit të rivlerësimit, kjo vepër sipas nenit 277 të Kodit Penal dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, parashikon ushtrimin e një të drejte nga personi që mendon se i përket dhe nuk njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent. Në rastin konkret, fakti që palët kishin një proces të hapur civil për të njëjtën çështje, tregon që i kallëzuar nuk kishte ndërmarrë veprime të njëanshme për të realizuar pretendime pronësore, por po priste vendimin e gjykatës. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk plotësoheshin elementet e figurës së kësaj vepre penale. Vendimi i mosfillimit nuk është ankimuar nga pala kallëzuese, rrethanë kjo që tregon se edhe vetë kallëzuesi ka qenë i bindur për drejtësinë e vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, sipas subjektit të rivlerësimit, pretendimi i Komisionerit Publik nuk gjen mbështetje as në aktet e administruara dhe as në arsyetimin ligjor të vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

33. Trupi gjykues mori në analizë shkaqet e ankimit të lidhura me këtë kallëzim, lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të indikatorëve të përcaktuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, sikundër pretenduar prej Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, si më poshtë:

33.1. Nga kontrolli i vendimit të marrë prej subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e kallëzimit penal nr. {***}/2015, trupi gjykues vëren se argumentet e tij për këtë vendimmarrje janë mbështetur në pamundësinë e tij për të identifikuar pronësinë mbi banesën objekt konflikti mes kallëzuesit dhe të kallëzuarit, në kushtet kur të dyja palët pretendonin pronësinë mbi këtë banesë. Sipas arsyetimit të subjektit të rivlerësimit, çështja e pronësisë së banesës, që do të duhej të zgjidhej nga gjykata në një proces civil, është një element i domosdoshëm i figurës së veprës penale “Shkatërrimi i pronës” apo “Vetëgjyqësia”, të pretenduara nga ana e kallëzuesit se janë kryer nga i kallëzuari. Në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen e kallëzimit penal, rezultoi se pas regjistrimit të kallëzimit, veprimet hetimore të kryera kanë qenë marrja e deklarimeve të kallëzuesit A. A. dhe marrja e deklarimeve dhe dokumentacionit prej të kallëzuarit R. A. Nga deklarimet e tyre rezulton se ndërsa kallëzuesi pretendon se i kallëzuari i ka prishur banesën në pronësi të tij, i kallëzuari në të kundërt pretendon se kjo banesë nuk ka qenë asnjëherë në pronësi të z. A. A., por është në pronësi të nënës së të kallëzuarit dhe ajo aktualisht jeton aty. Nga dokumentacioni i paraqitur nga palët rezulton se

secili prej tyre ka paraqitur Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, i cili përcakton sipërfaqet e tokës të përfituara sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, nga shtetasi A. A. dhe shtetasi B. A. Kallëzuesi ka paraqitur edhe listën emërore të fshatit {***}, i cili mban vulën e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, në të cilën pasqyrohet sipërfaqja e truallit dhe sipërfaqja e banesës në emër të tij.

Në vendimin e mosfillimit të procedimit penal, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: *“Pavarësisht se u paraqitën akte të marrjes së tokës në pronësi, të cilat në vetvete pasqyrojnë sipërfaqe toke bujqësore dhe trualli të trajtuar në favor të familjeve bujqësore, në asnjë prej tyre nuk evidentohet banesa objekt kallëzimi”*. Trupi gjykues vëren se, referuar objektit të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, dhe nenit 4 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i cili parashikonte se dhënia e tokës bujqësore në pronësi realizohet dhe vërtetohet vetëm me dokumentin bazë unik, që është “akti i marrjes së tokës në pronësi”, si dhe referuar vetë formatit të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, në këtë dokument evidentohet vetëm toka bujqësore dhe lloji i saj si: “arë”, “truall”, “pemëtores”, “vreshtë” dhe “ullishte”, por jo ndërtesa që mund të gjendej mbi të. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: *“Kjo banesë pasqyrohet vetëm në aktin e ekspertimit të kryer në funksion të një procesi gjyqësor civil midis tyre, në të cilin evidentohet se banesa ndodhet brenda sipërfaqes së trajtuar në favor të familjes B. A.”*. Në ndryshim nga sa ka konstatuar subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se nga akti i ekspertimit, i cituar nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton që ekspertja përkatëse të ketë dalë në një përfundim të tillë.

33.2. Në kuadër të të dhënave të analizuara si më sipër, trupi gjykues vlerësoi se veprimet verifikuese të kryera nga subjekti i rivlerësimit nuk ishin të mjaftueshme për të kuptuar natyrën e faktit, për të cilin kallëzuesi ka pretenduar se përbënte fakt penal. Në vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës të Lartë theksohet se: *Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi. Veprimet verifikuese duhen kryer në drejtim të verifikimit të shkaqeve të mosfillimit, por jo të hetimit me themel të ekzistencës të faktit penal dhe të zbulimit të fakteve lidhur me themelin e fajësisë apo të pafajësisë*. Në kontekst të këtij qëndrimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara rreth natyrës së veprimeve që mund të kryhen përpara se të vendoset për regjistrimin ose mosfillimin e një procedimi penal, si dhe në mbështetje të deklarimeve krejtësisht të kundërta të kallëzuesit dhe të të kallëzuarit, lidhur me banesën objekt kallëzimi, duket se ishte e nevojshme kryerja e veprimeve hetimore për verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, si këqyrja në terren e banesës së pretenduar nga kallëzuesi, se është shkatërruar nga i kallëzuari. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se aktet verifikuese tregonin se dëmtimet e konstatuara në banesë ishin të vjetra dhe nuk mund t’i atribuoheshin ndonjë veprimi të kohëve të fundit apo sjelljeje penalisht të ndëshkueshme, por nuk evidentoi se cilat ishin këto akte, për më tepër, nga verifikimi i dosjes penale, trupit gjykues nuk i rezultoi se ishin administruar akte të tilla, që buronin nga veprime verifikuese të kryera apo të urdhëruara nga subjekti i rivlerësimit. Edhe pse palët kanë pretenduar se ishin në proces gjyqësor civil, madje i kallëzuari ka pretenduar se është gjyqfytues dhe gjykata ka detyruar të kallëzuarin për të liruar sipërfaqen e tokës në pronësi të tij, nga subjekti i rivlerësimit nuk është kryer asnjë veprim hetimor për të verifikuar statusin në të cilin ndodhej procesi civil.

33.3. Megjithëse, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar lidhur me pamundësinë e palëve për të provuar se cilës prej tyre i përket pronësia mbi banesën, në vendim ka arritur në përfundimin se: “Nga sa u trajtua më lart, rezulton se banesa ka qenë e vjetër dhe e amortizuar, pasi është ndërtuar në vitin 1961 dhe, për rrjedhojë, nuk kemi shkatërrim të pronës me dashje, siç pretendohet në kallëzim dhe në këto kushte nuk do të fillohet ndjekja penale”. Një përfundim ky që duket se nuk varet nga tagri i pronësisë së kallëzuesit apo të të kallëzuarit mbi këtë banesë dhe që e bazon zgjidhjen e çështjes vetëm mbi këtë fakt dhe e bën të pavlerë arsyetimin e bërë në paragrafët pararendës të vendimit të mosfillimit të procedimit penal. Subjekti i rivlerësimit ka arritur në këtë përfundim pa kryer asnjë veprim hetimor, të nevojshëm për të arritur në këtë konkluzion, për të cilin kërkohen njohuri të posaçme në fushën e ndërtimit, për rrjedhojë, ky përfundim duhet të vinte si pasojë e një akti ekspertimi për të përcaktuar nëse objekti është prishur për shkak të amortizimit apo nga ndërhyrjet e jashtme të të kallëzuarit. Këto veprime hetimore mungojnë si parakushte të vendimmarrjes për mosfillimin e procedimit penal të marrë prej subjektit të rivlerësimit.

Duke respektuar kufijtë e nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit aftësitë profesionale vlerësohen pa gjykuar mbi themelin e çështjes dhe pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e prokurorit, nga përmbajtja e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, trupi gjykues konstatoi mangësi lidhur me argumentimin ligjor të vendimmarrjes. Arsyetimi i subjektit të rivlerësimit vlerësohet sipërfaqësor, pa një analizë të elementeve të anës subjektive/objektive të veprave penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Vetëgjyqësia”, të parashikuara nga nenet 150 dhe 277 të Kodit Penal dhe pa kryer veprimet hetimore të nevojshme, edhe për shkak të kushtëzimit të veprimeve hetimore nga ana e tij, me bindjen e brendshme, të shprehur në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, *se kallëzimi që ka bërë shtetasi A. A. është bërë me qëllimin e vetëm për të rënduar palët e tjera që ai ishte në konflikt pronësie.*

33.4. Për veprën penale “Vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal pa analizuar elementet e figurës së veprës penale në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes, si dhe me praktikën gjyqësore. Për sa i përket shpjegimit të subjektit të rivlerësimit, se ka vendosur mosfillimin për shkak se mosmarrëveshja ishte duke u shqyrtuar nga gjykata civile, ky shpjegim nuk mbështetet në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, nenit 70 dhe 71 të tij, ku përcaktohen normat lidhur me efektet e ndërsjella të vendimit penal dhe procedimeve civile dhe administrative, me rrjedhoja në hetimin penal.

34. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se gjendet i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se, subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, në aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
35. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit *për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e pezullimit të këtij procedimi, ka treguar mangësi sipas përcaktimit të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi sa vijon.*

36. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar prej Komisionit³⁰ gjatë hetimit administrativ për këtë procedim penal, trupi gjykues vëren se:

36.1. Me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, datë 27.04.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2014, për veprat penale “Vrasje me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 278/4 të Kodit Penal, sipas referimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier, se në datën 26.04.2014, rreth orës 20.30, në Patos, është vrarë me armë zjarri shtetasi B. RR. (*alias* N. M.). Viktima ka qenë duke ecur i vetëm, në këmbë, për në banesën e tij dhe rreth 50 metra larg hyrjes së pallatit ku banonte, persona të paidentifikuar e kanë qëlluar me armë zjarri, duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme.

36.2. Me referimin e ngjarjes, Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier ka përcjellë në Prokurori edhe dokumentacionin e përpiluar në datën e ngjarjes, 26.04.2014, për veprimet hetimore të kryera nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, konkretisht: Procesverbal për këqyrjen e vendit të ngjarjes, datë 26.04.2014; procesverbal për këqyrjen e kufomës së shtetasit B. RR., datë 26.04.2014; procesverbal për këqyrjen e sendit, datë 27.04.2014, në të cilin përshkruhet këqyrja e automjetit tip “Opel”, në pronësi të shtetasit A. M., i cili ka qenë i parkuar në vendngjarje dhe dyshohej se autorët e veprës penale kanë qenë të fshehur pas këtij mjeti; procesverbal për kontrollin e vendeve, datë 27.04.2014; vendim i Oficerit të Policisë Gjyqësore “Për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor”, datë 26.04.2014; akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr. {***}, datë 26.04.2014; procesverbal për sekuestrimin e sendeve; procesverbal për sekuestrimin e provës materiale; vendime të marra në datat 26.04.2014 dhe 27.04.2014 nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, përkatësisht për kryerjen e ekspertimit vlerësues, për kryerjen e ekspertimit krahasues, për kryerjen e ekspertimit kimik, për kryerjen e ekspertimit balistik vlerësues, për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit biologjik, si dhe për kryerjen e ekspertimit balistik krahasues.

36.3. Nga momenti i regjistrimit të procedimit penal në datë 27.04.2014, deri në pezullimin e tij më datë 21.07.2015, subjekti i rivlerësimit ka autorizuar oficerët e Policisë Gjyqësore për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, me qëllim zbardhjen e ngjarjes. Nga këto veprime hetimore, ndër të tjera, kanë rezultuar të dhënat si vijon:

36.3.1. Më datë 13.05.2014 janë marrë deklaratimet e z. B. RR., daja i viktimës, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, i cili, ndër të tjera, ka deklaruar se: *Para rreth 6 muajsh [...] më ka marrë në telefon me numër grek, shtetasi A. M., nga {***} i Patosit. [...] A. është vëllai i shtetasit D. M., të cilit në vitin 2010 i kanë vrarë në Itali djalin E. M. A. më pyeti në lidhje me një person me nofkën G. [...]. Nga verifikimet që bëra [...] mësova se G. ishte I. B. nga Klosi [...]. Rreth dy muaj nga biseda e fundit [...] A. më mori përsëri në telefon me numër grek dhe më tha: G. ishte në Shqipëri dhe iku pa i hyrë gjemb në këmbë, sepse ata që kishte paguar vëllai im, D., nuk e shkrepën. Unë e pyeta kush ishte personi që do ta shkrepente dhe A. m'u përgjigj: ishte [...] T. M. [...] Kur u vra djali i D. në Itali, unë kam biseduar me A. dhe ai më tha se të gjitha dyshimet i kishin te G. nga Klosi.*

³⁰ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.11.2023, ka përcjellë në Komision aktet e çështjes penale nr. {***}, të vitit 2014, lidhur me vrasjen e shtetasit N. M.

36.3.2. Z. B. RR. ka dhënë deklaratime në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale edhe më datë 19.02.2015, dhe ndër të tjera, ka deklaruar se nga biseda që pasur me vëllain e vet, P. RR., ky i fundit i ka treguar se viktimë ka pasur shok fëmijërie shtetasin L. S., me të cilin kishin miqësi familjare, por kohët e fundit para ngjarjes kishin pasur debate dhe nuk kishin komunikuar më me njëri-tjetrin. Sipas deklaratës, viktimë kishte pasur më përpara lidhje shoqërore dhe me shtetasin L. M. dhe vëllain e tij A. M., dhe se këta të fundit i kishin borxh një sasi parash viktimës.

36.3.3. Më datë 26.12.2014, janë marrë deklaratimet e znj. F. M., nëna e viktimës, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, e cila, ndër të tjera, ka deklaruar se viktimë ka pasur para katër vitesh një konflikt me djalin e M. (D.) M. nga Fieri, të cilin e ka qëlluar në Itali me shishe në kokë.

36.3.4. Më datë 26.12.2014, janë marrë deklaratimet e znj. A. M., bashkëshortja e viktimës, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, e cila, ndër të tjera, ka deklaruar se viktimë nuk ka pasur asnjëherë konflikte, vetëm se ka dëgjuar nga të tjerët se ka pasur një zënkë me djalin e M. (D.) M.

36.3.5. Më datë 30.06.2014, janë marrë deklaratimet e z. D. S., në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, i cili, ndër të tjera, ka deklaruar se viktimë me xhaxhain e tij, L. S., kanë qenë shokë fëmijërie dhe se xhaxhai i tij ka rreth 4 a 5 muaj që ka ardhur nga Anglia në Shqipëri dhe kur vjen, rri në të njëjtën banesë me deklaratësin dhe familjen e tij.

36.3.6. Nga z. G. M., vëllai i viktimës është dorëzuar në prokurori një aparat telefoni celular i markës “Nokia”, që pretendohet se i përkiste viktimës. Ky aparat, pas sekuestrimit, i është nënshtruar këqyrjes, nga ka rezultuar se në datën 23.11.2012, në numrin e telefonit të viktimës, nga një numër telefoni anglez, ka mbërritur mesazhi: “Mos nis më mesazh ashtu me mpirës se do na marrësh në qafë. Sa për mpirës të thashë 100 herë dhe si e doje të erdhi, dhe më i mirë dhe nuk do të të pres ty të m’i japësh nga 500 mijë lekë në muaj, se nuk ia dredh dot shokut si ty unë”.

36.3.7. Nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me anë të letërkërkesës për ndihmë juridike në fushën penale, me nr. {***} prot., datë 27.02.2015, me objekt: “Kryerja e veprimeve hetimore për marrjen e provave”, është kërkuar ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore të Mbretërisë së Bashkuar, për të identifikuar personin që ka disponuar, në datën 23.11.2012, numrin e telefonit, nga i cili ishte nisur mesazhi i sipërcituar në drejtim të viktimës, B. RR. Gjithashtu, janë kërkuar, ndër të tjera, edhe fluksi i sms-ve, si dhe bisedat hyrëse dhe dalëse për këtë numër, për periudhën 22.11.2012 – 26.04.2014.

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.05.2015, ka njoftuar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, lidhur me kërkesën e autoriteteve britanike për informacion plotësues lidhur me kërkesën për ndihmë juridike në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2014.

Referuar kërkesës së autoriteteve britanike, janë kërkuar shpjegime përse provat e kërkuara janë nga periudha 22.11.2012 – 26.04.2014, kur vepra penale është kryer më datë 26.04.2014. Sipas autoriteteve britanike duhet të ketë një lidhje të qartë mes provave të kërkuara dhe veprës penale nën hetim. Autoritetet britanike kanë kërkuar informacionin si më sipër, dhe nëse ky informacion nuk jepej brenda tre muajve, atëherë dosja do të konsiderohej e mbyllur.

36.3.8. Në vendimin “Për pezullimin e procedimit penal nr. {***}/2014”, datë 21.07.2015, subjekti i rivlerësimit, ka arsyetuar, ndër të tjera: [...] *Me anë të shkresës nr. {***}, datë 25.02.2015, Drejtorisë së Policisë Shkencore Tiranë i është dërguar vendimi për kryerje ekspertimi teknik kompjuterik për dy aparatet e telefonit që ka pasur viktimja B. RR. Me shkresën nr. {***}, datë 30.04.2015, Drejtoria e Policisë Shkencore Tiranë ka dërguar aktin e ekspertimit nr. {***}, datë 30.04.2015. Nga verifikimi i CD-së së dërguar me aktin e ekspertimit u konstatua se te aparati telefonik [...] Samsung dhe konkretisht te rubrika “Android WhatsApp contacts”, në listën e kësaj rubrike ku ishin emrat dhe numrat telefonik të regjistruar, u konstatuan me interes [...] numri telefonik {***} i regjistruar me emrin L. (ky numër përkon me numrin që i ka dërguar mesazh dhe që është gjetur në këqyrjen e telefonit “Nokia” [...]. Është këqyrtur sistemi TIMS për të mësuar rreth hyrje-daljeve të shtetasit L. S. dhe nga këqyrja rezultoi se ky shtetas për herë të fundit ka hyrë në Shqipëri nga Kakavija më datë 15.04.2014, dhe ka dalë nga Shqipëria nëpërmjet pikës kufitare Rinas më datë 18.04.2015. Me shkresën nr. {***}, datë 27.02.2015 është dërguar letërporosi për verifikimin vetëm të numrit {***}. Me shkresën nr. {***}, datë 13.05.2015, të dërguar nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Tiranë, njoftohemi se Autoriteti Qendror Britanik (UCKA) nuk mund të pranonte kërkesën tonë.*

36.3.9. Në kërkesën e datës 13.05.2014, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: “Kërkohet lejimi i përgjimit”, subjekti i rivlerësimit ka referuar, ndër të tjera: *Nga informacionet që ka Policia Gjyqësore, viktimja ka pasur konflikt me shtetasin D. M. [...]. Në vitin 2010, shtetasit D. M. i është vrarë djali në Itali dhe një nga bashkëpunëtorët dyshohet të jetë viktimja B. RR. [...] Nga Policia Gjyqësore disponohen të dhëna se shtetasi D. M. ka paguar shtetasin A. B. për të vrarë B. Po kështu ka të dhëna se shtetasi B. RR. ka konflikt me shtetasin A. M., për problemin e një prostitute në Itali.*

36.3.10. Në procesverbalin “Mbi transkriptimin e përgjimit të komunikimeve të numrit të telefonit celular”, datë 04.02.2015, Oficeri i Policisë Gjyqësore ka konstatuar se CD-të që i përkasin përgjimeve të numrit të telefonit celular që i përket shtetasit A. B., nuk hapen në kompjuter. Në vendimin “Për pezullimin e procedimit penal nr. {***}/2014”, datë 21.07.2014, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar, ndër të tjera: *Në lidhje me numrin telefonik që i përket shtetasit A. B., nga vendosja e CD-së në disa kompjutera, u konstatua se ajo nuk hapej dhe nuk mund të lexoheshin të dhënat që mund të ketë brenda. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar edhe se: Nga analiza e transkriptimit të thirrjeve telefonike të numrit që i përket shtetasit D. M., ka rezultuar se subjektit i është bërë qejfi që është vrarë nipi i B., pasi sipas tyre ka pasur dorë te vrasja e djalit të tyre. Gjithashtu, në një bisedë që ky numër ka pasur me numrin telefonik x, biseda përqendrohet te një person me emrin G., i cili ka qenë dhjetë ditë para vrasjes dhe këtë gjë e dinte policia dhe se subjekti ka thënë këto fjalë: “Më pyetën, por i pashë që ishin aty tek ti, nuk e di që janë zemëruar me njëri-tjetrin andej ata dhe e vranë atë ata”.*

36.3.11. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar si vijon.

Sa më lart, duket se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin e datës 21.07.2015 për pezullimin e procedimit penal nr. {***}/2014, jo sipas parashikimeve të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, pasi: (i) nuk ka administruar kopjen e përgjimeve të shtetasit A. B. nga Sektori i Përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të këtij shtetasi, në kushtet kur ka pasur indicie se ky person është paguar për kryerjen e vrasjes së shtetasit

I. B. (G.), për të cilin janë ngritur dyshime se, së bashku me viktimën, kanë lidhje në vrasjen e një shtetasi shqiptar në Itali; (ii) nuk ka kryer veprime hetimore ndaj shtetasit I. B., për të cilin ka pasur indicie se ka pasur marrëdhënie me viktimën, marrëdhëniet ndërmjet tyre janë prishur dhe mund ta ketë vrarë; (iii) nuk ka marrë në pyetje si dhe nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të shtetasit L. S. në kushtet kur familjarët e viktimës kanë ngritur dyshime se ka lidhje në vrasjen e viktimës; (iv) nuk ka kryer hetime ndaj shtetasve L. M. dhe A. M. në kushtet kur nga hetimet ka rezultuar se këta shtetas i kanë pasur para borxh viktimës.

36.3.12. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:

*Lidhur me kryerjen e veprimeve hetimore ndaj shtetasve A. B., I. B. (G.), L. S., L. M. dhe A. M. të dyshuar si autorë apo bashkautorë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së shtetasit B. RR. (N. M.), nga ana ime si prokuror, por në bashkëpunim dhe me oficerët e Policisë Gjyqësore, veprimet hetimore ndaj tyre nuk janë kryer, pasi nuk janë gjetur, me dyshimin se janë larguar jashtë territorit të Shqipërisë në mënyrë të jashtëligjshme. Por dua të theksoj se, në fakt, ata janë hetuar duke qenë subjekte të përgjimeve të ndryshme. Pikërisht për arsyet e mësipërme, edhe Oficeri i Policisë Gjyqësore, në relacionin e tij, të datës 13.07.2015, ka sugjeruar pezullimin e hetimeve të procedimit penal të deleguar me nr. {***}, të vitit 2014, duke ia deleguar dosjen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me 40 CD-të (për transkriptim) të administruara në dosje, relacion të cilin e kam pranuar edhe unë si prokuror i çështjes, ku kam vendosur pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}, datë 27.04.2014. Përveç sa më sipër, kam mendimin se përderisa procedimi i mësipërm nuk ka përfunduar, Komisioni nuk ka kompetencë për të marrë në shqyrtim këtë çështje lidhur me vlerësimin tim, pasi këtë e ndalon paragrafi i parë i nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pika 4, e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.*

37. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ mbi procedimin penal nr. {***}/2014³¹, të trajtuar nga subjekti i rivlerësimit, në vendim³², ka konkluduar se: “Trupi gjykues, në analizë të rrethanave të kësaj çështjeje dhe shpjegimeve të subjektit, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, si marrja në pyetje e familjarëve të viktimës dhe shtetasve të tjerë që mund të kenë pasur dijeni për ngjarjen, janë kryer veprimet e përgjimit ndaj disa shtetasve të dyshuar, ekspertimet daktiloskopike ndaj disa shtetasve, ekspertimet biologjike, kimike, ekspertimi kimik dhe balistik i gëzhjojave të gjetura në vendin e ngjarjes, verifikime të sistemit TIMS, por nuk është bërë i mundur identifikimi i autorit të veprës penale. Në këto kushte është vlerësuar në tërësi, duke disponuar me pezullimin e çështjes për shkak të mos zbulimit të autorit, ku vërehet gjithashtu se drejtuesi i organit të akuzës nuk ka rezultuar në një vendimmarrje ndryshe për të rinisur hetimet dhe, në këto kushte, vlerëson se nuk ka kompetencë shqyrtimi të thëlluar në këtë çështje. Trupi gjykues, përveçse konstatoi se subjekti ka ndërmarrë një sërë veprimesh hetimore për zbardhjen e rrethanave të çështjes, por në statusin që ajo është, ku të dhënat ndaj hetimit janë të limituara apo të kufizuara, zbulimi i të cilave mund të dëmtojë hetimin, nuk krijon një panoramë të plotë për të vlerësuar rolin dhe pozitën e subjektit të rivlerësimit në të dhe, për pasojë, çmon se në këtë rast nuk mund të

³¹ Evidentuar si çështje nga Komisioni, pas verifikimit të Raportit të KLP-së për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj, nr. {***} prot., datë 10.07.2023, të rubrikës “Të dhëna nga burimet arkivore”, si ankesë e znj. F. M. (nr. {***} e vitit 2018), e cila ka kërkuar informacion nëse është zbuluar autori i vrasjes së djalit të saj B. RR. (N. M.), në vitin 2014, duke përmendur se çështja hetohet nga prokuror Petrit Vukaj. Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar për vlerësim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

³² Paragrafët 43.4 - 43.5 të vendimit të Komisionit.

evidentohen shkaqe të tilla që të kualifikohen si mangësi të subjektit, sipas neneve 40 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016”.

37.1. Komisioneri Publik, në ankim, ndryshe nga sa ka arritur në përfundim Komisioni, ka vlerësuar se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. {***}, viti 2014, nuk janë bindëse, pasi ka disponuar pezullimin e hetimeve pa ezauruar të gjitha veprimet e mundshme procedurale, konkretisht si vijon:

(i) subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore lidhur me shtetasin A. B., në kushtet kur ka pasur indicie se ky person është paguar për kryerjen e vrasjes së shtetasit I. B. (G.), për të cilin janë ngritur dyshime se, së bashku me viktimën, kanë lidhje në vrasjen e një shtetasi shqiptar në Itali. Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të jetë kërkuar kopje tjetër CD-je e aksesueshme për përgjimet e këtij shtetasi, nga Sektori i Përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme.

(ii) Nuk rezulton të jenë kryer veprime hetimore ndaj shtetasit I. B., për të cilin ka pasur *indicie* për vrasjen e viktimës.

(iii) Nuk është marrë në pyetje shtetasi L. S., me të cilin viktimja ka pasur mosmarrëveshje, si dhe nuk janë kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të tij. Në të njëjtat marrëdhënie viktimja ka rezultuar me shtetasin L. M. dhe vëllain e tij, A. M., por nga subjekti i rivlerësimit nuk rezulton që të jenë kryer veprime procedurale me këta shtetas.

Komisioneri Publik ka vlerësuar se Komisioni nuk ndodhej në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, por legjitimohej të analizonte e vlerësonte këtë çështje në kuadër të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

37.2. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik si më sipër, duke vlerësuar se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin e pezullimit të procedimit penal, tregon për mangësi profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016.

37.3. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, prapësoi se sa i përket pretendimit se nuk janë kryer veprime hetimore ndaj shtetasve I. B., L. S., L. M. dhe A. M., këta persona kanë qenë objekt verifikimi dhe vlerësimi të vazhdueshëm në kuadër të hetimit. Megjithatë ka rezultuar se këta persona nuk janë gjetur fizikisht, ndërkohë që dyshimet e bazuara operative kanë qenë se ata ishin larguar jashtë vendit në mënyrë të jashtëligjshme, pa e bërë të mundur ndjekjen e tyre përmes mjeteve alternative hetimore. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për komunikimet e shtetasit A. B. është mjaftuar me të dhënat e transkriptuara zyrtarisht, të cilat janë përcjellë nga Sektori i Përgjimeve me procesverbalin e datës 04.02.2015. Mosfunksionimi teknik i një mbajtësi elektronik, në vetvete, nuk përbën provë të mungesës së veprimeve hetimore të mëtejshme ndaj këtij shtetasi. Vendimi për pezullimin e procedimit penal ka qenë një zgjidhje procedurale e ligjshme dhe e arsyetuar, në mungesën e provave të reja dhe në pamundësinë objektive për të vijuar më tej hetimin në mënyrë efektive, në përputhje të plotë me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale.

38. Në vlerësim të pretendimeve të Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues, fillimisht mori në analizë çështjen nëse Komisioni, në kuadër të situatës faktike të sipërcituar, kishte juridiksion kontrollues mbi vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit për

pezullimin e procedimit penal nr. {***/2014, në kuptim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: “Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim”. Trupi gjykues vëren se, në kuadër të legjislacionit procedural penal, në fuqi në kohën kur është hetuar çështja, i cili rregullonte marrëdhëniet hierarkike në organizimin dhe funksionimin e prokurorisë si një organ i centralizuar, konkretisht nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i pezullimit të procedimit penal, datë 21.05.2015, objekt analize, është kontrolluar vetëm nga prokurori më i lartë, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, i cili duket se e ka miratuar këtë vendim të subjektit të rivlerësimit.

Në mbështetje të parashikimit të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale³³, sipas të cilit hetimi i pezulluar rifillon me vendim të prokurorit, konstatohet se që nga momenti i marrjes së vendimit të pezullimit të procedimit penal nr. {***/2014, më datë 21.07.2015 (përcjellë në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, më datë 23.07.2015) e deri në momentin e zhvillimit të seancës dëgjimore publike në Komision, më datë 10.06.2024, pra gjatë një periudhe rreth 9-vjeçare, nuk rezultonte që subjekti i rivlerësimit të kishte ndërmarrë ndonjë veprim për rifillimin e hetimeve për çështjen në fjalë. Në kushtet kur objekt vlerësimi në këtë proces është veprimtaria e subjektit të rivlerësimit deri në momentin e marrjes së vendimit të pezullimit të procedimit penal, veprimtari e ezauruar nga subjekti i rivlerësimit e që nuk i është nënshtruar asnjë kontrolli gjyqësor³⁴, kjo çështje në momentin e zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision nuk ishte duke u shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit. Në mbështetje edhe të jurisprudencës së Kolegjit, sipas së cilës: “Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: [...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë”, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni nuk ka qenë në kushtet e pengesës ligjore dhe ishte i legjitimuar të analizonte e vlerësonte edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

38.1. Në vijim të analizës, në vlerësim të pretendimeve të Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se subjekti i rivlerësimit ka pezulluar çështjen pa kryer një hetim të plotë, referuar rrethanave faktike të pasqyruara më sipër, trupi gjykues, pa vlerësuar ligjshmërinë e veprimtarisë apo logjikën e hetimit, si dhe zgjidhjen e çështjes, konstatoi një veprimtari të pamjaftueshme hetimore, e cila nuk pajtohet me parashikimin e nenit 326, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: “Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme.”

38.1.1. Lidhur me shtetasin A. B., subjekti i rivlerësimit, edhe pse në kërkesën e datës 13.05.2015, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ka evidentuar rëndësinë e lejimit të përgjimeve të komunikimeve telefonike të këtij shtetasi, pasi nga Policia Gjyqësore disponoheshin të dhëna se ishte paguar për të vrarë viktimën, nga aktet e administruara në dosjen e procedimit penal, rezulton se veprimet e mëtejshme hetimore janë kufizuar vetëm në konstatimin nga oficeri i policisë gjyqësore, në procesverbalin “Mbi transkriptimin e përgjimit të komunikimeve të numrit të telefonit celular”,

³³ Legjislacioni në fuqi në kohën e vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit, por edhe gjatë kohës së zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision.

³⁴ Referuar parashikimeve të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi në vitin 2015, nuk parashikohej ankimi ndaj këtij vendimi të prokurorit.

datë 04.02.2015, se CD-të që i përkasin përgjimeve të numrit të telefonit celular që i përket shtetasit A. B. nuk hapen në kompjuter. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë autorizuar kërkimin e një kopjeje tjetër CD-je pranë Sektorit të Përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, në mënyrë që të bëhej i mundur aksesimi i materialit të përgjimit dhe transkriptimi i tij, me qëllim të nxjerrjes së të dhënave në dobi të zbardhjes së çështjes. Gjithashtu, nuk rezulton që të jenë ndërmarrë veprime të tjera hetimore lidhur me këtë shtetas. Në vendimin “Për pezullimin e procedimit penal nr. {***}/2014”, datë 21.07.2014, subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar vetëm se në lidhje me numrin telefonik që i përket shtetasit A. B., nga vendosja e CD-së në disa kompjutera, u konstatua se ajo nuk hapet dhe nuk mund të lexoheshin të dhënat që mund të ketë brenda, pa arsyetuar pse veprimet hetimore për këtë shtetas nuk kanë vijuar më tej, në kushtet kur për të kishte indicie se mund të kishte qenë personi që kishte kryer veprën penale.

38.1.2. Lidhur me shtetasin I. B., i njohur ndryshe si “G.”, nga verifikimi i dosjes së procedimit penal objekt kontrolli, rezulton se për të nuk janë kryer veprime hetimore, edhe pse nga deklaratimet e shtetasit B. RR., daja e viktimës, si dhe nga transkriptimi i përgjimeve telefonike të shtetasit D. M., “G.” dyshohej se, në vitin 2010, i kishte vlarë në Itali djalin, shtetasin E. M. Nga transkriptimet ka rezultuar gjithashtu, se shtetasi D. M. dhe bashkëshortja e tij, F. M., besonin se viktimë B. RR. kishte bashkëpunuar me I. B. për vrasjen e djalit të tyre dhe gjatë bisedave telefonike janë hedhur dyshime se mes tyre mund të kishte pasur grindje, dhe për pasojë I. B. mund të kishte vlarë viktimën. Në vendimin për pezullimin e procedimit penal, subjekti i rivlerësimit ka referuar rezultatet e veprimeve hetimore për sa i përket deklaratimeve të shtetasit B. RR. dhe bisedave të transkriptuara të familjarëve të shtetasit të vlarë në Itali, po nuk ka arsyetuar pse hetimet për shtetasin I. B. janë ndaluar pa u shtrirë më tej, në kushtet kur për të kishte indicie se mund të kishte qenë personi që kishte kryer veprën penale.

38.1.3. Sa i përket shtetasit L. S., emigrant në Mbretërinë e Bashkuar, për të cilin nga deklaratimet e shtetasit B. RR., janë përfutur të dhëna se ka qenë shok fëmijërie me viktimën por, përpara ngjarjes, kishin pasur debate dhe nuk komunikonin më, dhe se vjehri i viktimës, pas ngjarjes, kishte akuzuar shtetasin SH. S. (vëllai i L.) se i kishte bërë gjëmën dhe i kishte lënë fëmijët jetimë, nga verifikimi i akteve të dosjes së procedimit penal, ka rezultuar se veprimet hetimore lidhur me të janë kufizuar vetëm në pyetjen e nipit të tij, D. S., lidhur me marrëdhëniet me viktimën, si dhe këqyrjen e sistemit TIMS, nga ka rezultuar se në kohën kur ka ndodhur ngjarja, shtetasi L. S. ka qenë në territorin shqiptar.

Për shkak se në telefonin celular të viktimës është gjetur një mesazh, i ardhur nga një numër celular anglez, i cili kishte përmbajtje me interes për ngjarjen, nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me anë të letërkërkesës për ndihmë juridike në fushën penale, me nr. {***} prot., datë 27.02.2015, është kërkuar ndihmë juridike nga autoritetet gjyqësore të Mbretërisë së Bashkuar, për të identifikuar personin që ka disponuar numrin e telefonit nga i cili ishte nisur mesazhi i sipërcituar në drejtim të viktimës B. RR.

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.05.2015, ka njoftuar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier lidhur me kërkesën për informacion plotësues të autoriteteve britanike, lidhur me kërkesën për ndihmë juridike në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2014, informacion i cili duhej të dërgohej brenda tre muajve, në të kundërt dosja do të konsiderohej e mbyllur.

Në aktin e ekspertimit nr. {***}, datë 30.04.2015, “Për ekspertim telefonash celularë dhe kartash SIM”, nga eksperti është konstatuar se te aparati telefonik [...] Samsung, që i përkiste viktimës B. RR., në rubrikën “WhatsApp contacts”, gjendej i regjistruar numri telefonik {***}, i regjistruar me emrin L., numër i cili përkonte me numrin anglez që i kishte dërguar viktimës mesazhin e cituar më sipër dhe që është konsideruar me interes për ngjarjen.

Në kushtet kur ekzistonin të gjitha këto indicie për një marrëdhënie miqësore të prishur mes viktimës dhe shtetasit L. S., duket e pajustificuar mungesa e veprimeve hetimore ndaj këtij shtetasi në kërkim të lidhjeve të mundshme mes tij dhe ngjarjes. Ekzistenca e këtyre indicieve shtesë të përfuara nga rezultatet e aktit të ekspertimit nr. {***}, datë 30.04.2015, duket se nxirrin në pah nevojën për ndihmën nga autoritetet gjyqësore të Mbretërisë së Bashkuar, të cilëve iu ishte kërkuar tashmë të identifikonin individin që posedonte numrin e telefonit anglez, që viktimë e kishte të regjistruar nën emrin “L.”. Në këto kushte, mbetet e paqartë se përse subjekti i rivlerësimit, jo vetëm që nuk i ka përcjellë autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar informacionin shtesë të kërkuar prej tyre brenda afatit të përcaktuar prej tyre, por në vendimin e pezullimit të procedimit penal, pasi ka përshtetur veprimet hetimore të sipërcituara, ka referuar se Autoriteti Qendror Britanik (UCKA) nuk mund të pranonte kërkesën e drejtuar nga autoritetet shqiptare.

38.1.4. Nga deklaratimet e z. B. RR., ka rezultuar se viktimë i kishte dhënë para hua shtetasve L. M. dhe A. M., por nga subjekti i rivlerësimit nuk është ndërmarrë asnjë veprim hetimor në drejtim të këtyre shtetasve.

38.1.5. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të kryer në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, u vlerësuan nga trupi gjykues jobindëse dhe jo në përputhje me aktet e procedimit penal të pasqyruara prej tij në arsyetimin e vendimit të pezullimit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se veprimet hetimore ndaj shtetasve *A. B., I. B. (G.), L. S., L. M. dhe A. M. nuk janë kryer, pasi nuk janë gjetur, e dyshohet se janë larguar jashtë territorit të Shqipërisë në mënyrë të jashtëligjshme, por në fakt ata janë hetuar duke qenë subjekte të përgjimeve të ndryshme.* Nga vëzhgimi i akteve të procedimit penal, por edhe të arsyetimit të vendimit të pezullimit të procedimit penal, i cili është një analizë/pasqyrim i provave të mbledhura nga hetimi, nuk rezulton të jenë kryer këqyrje të sistemit TIMS për shtetasit A. B., I. B. dhe për vëllezërit M., për të verifikuar nëse kishin dalë jashtë vendit, dhe njëkohësisht në asnjë akt të këtij procedimi apo në informacionet e përcjella subjektit të rivlerësimit nga oficerët e Policisë Gjyqësore, nuk rezulton të jetë referuar se ka indicie se këta shtetas janë larguar jashtë vendit në mënyrë të paligjshme, si dhe nuk rezulton që të jetë dokumentuar dështimi i veprimeve hetimore për shkak se këta shtetas nuk gjenden. Në të njëjtën linjë, trupi gjykues vëren inkoherencë të qëndrimit të subjektit të rivlerësimit, pasi në rastin e shtetasit L. S., edhe pse nga hetimi rezultonte se ky shtetas kishte hyrë në Shqipëri më datë 15.04.2014, pak ditë para ngjarjes, dhe ka dalë nga territori shqiptar më datë 18.04.2015, rreth një vit pas ngjarjes, dhe nga deklaratimet e shtetasve B. RR. dhe D. S. rezultonte se ky shtetas ndodhej në Patos, nga subjekti i rivlerësimit nuk është ndërmarrë asnjë veprim hetimor në drejtim të marrjes së deklaratimeve prej tij. Edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit se këta shtetas janë hetuar pasi kanë qenë subjekte të përgjimeve, nuk përkon me të dhënat e akteve të procedimit penal, pasi subjekt i përgjimeve të komunikimeve telefonike ka qenë vetëm shtetasi A. B., për të cilin subjekti i rivlerësimit nuk ka vijuar me veprimet e duhura hetimore për të aksesuar materialin e përgjimit të kryer ndaj tij.

39. Nga sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se në ndjekjen e procedimit penal nr. {***}/2014, subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka kryer hetime shteruese dhe ezauruese për zbardhjen e ngjarjes, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, moskryerja e të cilave në vetvete materializon mangësitë profesionale të tij, në aspektin e njohurive ligjore dhe të arsytimit ligjor, sipas parashikimit të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

39.1. Pavarësisht sa më sipër, në vlerësimin lidhur me këtë çështje, trupi gjykues mbajti në konsideratë që vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit për pezullimin e hetimeve dhe përcjelljen e çështjes në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier:

(i) i është nënshtruar kontrollit hierarkik nga drejtuesit e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lidhur me veprimet hetimore të ndërmarra prej tij për zbardhjen e ngjarjes;

(ii) mund të revokohej në çdo moment, nëse nga hetimet e Policisë do të rezultonin prova dhe fakte të reja për hetimin e zgjidhjen e kësaj çështjeje/ngjarjeje.

40. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit: *Për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në aftësinë e prokurorit për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016*, trupi gjykues konstatoi dhe analizoi sa vijon.

41. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar prej Komisionit gjatë hetimit administrativ për këtë procedim penal³⁵, trupi gjykues vëren se:

41.1. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, më datë 01.04.2015, është regjistruar procedimi penal nr. {***}, i vitit 2015, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, e parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E. XH., i cili është arrestuar në flagrancë nga forcat e Komisarariatit të Policisë Fier, pasi në datën 31.03.2015, teksa ka qenë duke drejtuar automjetin tip “Mercedes-Benz”, ka humbur kontrollin e automjetit duke dalë nga rruga, e për pasojë ka ngelur i dëmtuar vetë, si dhe ka gjetur vdekjen shtetasi P. B., i cili ka qenë si pasagjer, në sediljen e pasme, në automjetin që drejtohej nga i pandehuri.

41.2. Më datë 02.04.2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të caktuar për hetimin e çështjes, ka paraqitur në gjykatë kërkesën për vleftësimin e masës së “arrestit në flagrancë” dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” për shtetasin E. XH. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. {***}, datë 04.04.2015, ka pranuar kërkesën e sipërcituar, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 07.05.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

41.3. Nga veprimet hetimore të kryera ka rezultuar se:

41.3.1. Në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, nr. {***}, datë 31.03.2015, mbi ekzaminimin e kufomës së shtetasit P. B., eksperti mjeko-ligjor ka arritur në përfundimin se viktimës i janë shkaktuar dëmtime me mjet të fortë, jo të mprehtë, me mekanizmin e goditjes me forcë në sende të forta dhe shkak i vdekjes është gjendja e shokut traumatiko-hemorragjik.

³⁵ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.10.2023, ka përcjellë në Komision aktet e çështjes penale nr. {***}, të vitit 2015.

41.3.2. Nga konkluzioni i aktit të ekspertimit autoteknik, datë 03.04.2015, rezulton se shkakua determinant i ndodhjes së aksidentit ka qenë shkelja rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i mjetit, i cili duke lëvizur me shpejtësi shumë të lartë, nga shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor interurban dytësor, nuk ka arritur të ruajë kontrollin e mjetit dhe për pasojë ka shkelur nenet 139, pika 2 dhe 140 të Kodit Rrugor.

41.3.3. Sipas aktit të ekspertimit toksikologjik, nr. {***}, datë 14.04.2015, mbi ekspertimin toksikologjik të gjakut të shtetasit E. XH, ka rezultuar se mostra e gjakut është e koagulluar dhe si e tillë nuk përbën një mostër të pranueshme për analizë.

41.3.4. Me vendimin e datës 15.05.2015, “Për njoftimin e akuzës”, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të marrë në cilësinë e të pandehurit shtetasin E. XH., pasi janë siguruar të dhëna të mjaftueshme se ky shtetas, me veprimet e tij, ka konsumuar veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, e parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal.

41.3.5. Me kërkesën e datës 18.05.2015, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar gjykimin e procedimit penal nr. {***}/2015, në ngarkim të shtetasit E. XH.

41.3.6. Në vijim të gjyqimit, referuar dokumentit që gjendet në dosjen e procedimit penal me titull “Diskutim përfundimtar”, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar: “[...] Nga sa del e provuar më lart, rezulton se i pandehuri E. XH. ka konsumuar elementet e veprës penale të ‘Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor’, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, pasi duke drejtuar automjetin tip ‘Benz’ ka aksidentuar me pasojë vdekjen e shtetasit P. B. I pandehuri E. XH., duke vepruar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në Kodin Rrugor për qarkullimin e automjeteve, nga pakujdesia e tij, ka dëmtuar shtetasin e lartpërmendur duke i shkaktuar vdekjen, e megjithëse nuk e ka dëshiruar këtë pasojë, mund të parashikonte mundësinë e ardhjes së saj, por me mendjelehtësi ka shpresuar në shmangien e saj. Në lidhje me masën e dënimit për të pandehurin E. XH., duhet të merret parasysh rrezikshmëria mesatare e veprës penale dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese, parashikuar nga nenet 48, 49 dhe 50 të Kodit Penal, si:

- fakti i të mos qenët i dënuar më parë;
- qëndrimin pohues ndaj akuzës;
- pendimi i thellë, neni 48, shkronja ‘ç’ e Kodit Penal;
- normalizimin e marrëdhënieve me familjarët e viktimës;
- faktin që është i martuar dhe me fëmijë të mitur.

Për këto arsye, në bazë të nenit 378/1 dhe 393/1 të Kodit Penal, kërkoj: 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit E. XH., për veprën penale ‘Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor’, dhe në bazë të nenit 290/3 të Kodit Penal, dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit E. XH. t’i zbritet një e treta e dënimit. 2. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit për të pandehurin E. XH., për një afat prej 3 vjetësh, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

Në përputhje me nenin 30, pika 3 dhe 37 të Kodit Penal, të pandehurit E. XH. t’i jepet një dënim plotësues ‘Ndalimi për të drejtuar automjete’, për një periudhë prej 2 vjetësh”.

41.3.7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. {***}, datë 07.10.2015, ka vendosur deklarinim fajtor të pandehurit E. XH., duke e dënuar me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe duke i zbritur 1/3 e dënimit e ka dënuar përfundimisht me 1 vit e 8 muaj burgim.

41.3.8. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 10.02.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

41.3.9. Komisionit, nga verifikimi i faqes elektronike të Gjykatës së Lartë, nuk i ka rezultuar që kjo çështje të jetë regjistruar në këtë gjykatë për gjykim.

41.3.10. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se:

(i) *Subjekti në dokumentin “Diskutim përfundimtar” drejtuar gjykatës ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim të pandehurit duke u bazuar vetëm në rrethanat që lidhen kryesisht me të pandehurin pa marrë në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprës penale si: (1) shkallën e pakujdesisë së autorit të saj, nga ku rezulton se aksidenti ka ardhur për shkak se drejtuesi i mjetit ka lëvizur me shpejtësi 161.6 km/orë nga 80 km/orë që ka qenë shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor; (2) pasojën shoqërisht të rrezikshme, vdekjen e shtetasit P. B.*

(ii) *Subjekti nëpërmjet kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duket të ketë favorizuar të pandehurin, dhe kjo kërkesë e subjektit së bashku me rrethanat e konstatuara në çështjen penale në ngarkim të tij, mund të çojnë në cenimin e besimit të publikut tek organet e drejtësisë.*

41.3.11. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

Pretendimin e mësipërm në raport e vlerësoj jo të bazuar, pasi:

*Së pari: Në raportin e Komisionit është evidentuar fakti se rrethanat e përcaktuara në nenin 59 të Kodit Penal janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe pikërisht këtë gjë e kam patur dhe unë parasysh kur kam paraqitur diskutimin përfundimtar përpara gjykatës. Së dyti: Po në diskutimin përfundimtar, ashtu siç është përmendur edhe në raport, unë kam patur parasysh edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, por në dallim nga sa pretendohet në raport, këto rrethana unë i kam vlerësuar në kuadrin e formës së fajit që ka qenë nga pakujdesia. Fakti që ligjvënësi e lidh pezullimin e ekzekutimit të dënimit me masën e dënimit deri në 5 vjet, do të thotë që shkalla e rrezikshmërisë shoqërore e veprës jo në çdo rast duhet të jetë e vogël. Së treti: Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit E. XH., unë kam patur parasysh ashtu siç është evidentuar dhe në diskutimin përfundimtar, rrezikshmërinë e paktë të personit, ku ai nuk ka qenë i dënuar më parë dhe as nuk është bërë ndonjëherë problem për veprime të kundërligjshme, normalizimin e marrëdhënieve me trashëgimtarët e viktimës, që provohet me deklaratat noteriale nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., dt.14.04.2015 të lëshuara nga bashkëshortja e viktimës shtetasja E. B. dhe deklarata noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt.15.04.2015, të lëshuar nga vëllai i viktimës shtetasi K. B., deklarinimet e shtetasit K. B., dt.15.05.2015, dhënë para meje, i cili ka konfirmuar deklaratën noteriale të lëshuar prej tij për normalizimin e marrëdhënieve, qëndrimin thellësisht pendues që ai ka mbajtur ndaj veprës penale, por edhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen ku i pandehuri E. XH. ka qenë i martuar dhe me dy fëmijë të mitur.*

Nga sa më sipër e konsideroj të pabazuar edhe pretendimin tjetër në raport, se unë kam patur si qëllim favorizimin e të pandehurit E. XH.

42. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ mbi procedimin penal nr. {***}/2015,³⁶ të trajtuar nga subjekti i rivlerësimit, në vendim³⁷, ka konkluduar se: *Trupi gjykues, në analizë të akteve në dosje e shpjegimeve të subjektit në raport me ligjin e aplikueshëm, vlerëson se në këtë çështje duhet konsideruar fakti që në këtë rast organi i akuzës/subjekti dispononte atributin e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, për sa kohë vepra penale për të cilën akuzohej i pandehuri lejonte një masë dënimi deri 5 vjet, në raport me rrethanat lehtësuese të cilat gjenden të arsyetuara nga subjekti në kërkesën e tij, më konkretisht: “të mos qenët i dënuar me parë, qëndrimi pohues ndaj akuzës, pendimi i thellë, normalizimi i marrëdhënieve me familjarët e viktimës, fakti që është i martuar dhe me fëmijë të mitur”. Po ashtu, duket se subjekti ka vlerësuar rrethanat e kësaj çështjeje në raport me kriteret e parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal, duke arsyetuar në dokumentin “Diskutime përfundimtare” nën kuadrin e formës së fajit nga pakujdesia, ku, megjithëse i pandehuri nuk e ka dëshiruar pasojën, ajo ka ardhur. Subjekti në kërkesën e tij para gjykatës i është referuar dispozitës që parashikon dënimin maksimal deri në 5 vjet dhe, për rrjedhojë, lejon aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe në zbatim të kësaj të fundit ka konsideruar faktet e provuara se i pandehuri ka qenë i padënuar më parë dhe se ka rregulluar marrëdhëniet me familjarët e viktimës. Trupi gjykues, në këtë arsyetim, mban në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për çështje të kësaj natyre. Trupi gjykues, referuar nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, çmon se jemi përpara rastit kur logjika e subjektit nuk mund të zëvendësohet, për sa kohë në dosje provohet se subjekti ka kryer veprime hetimore të plota, të vlerësuara edhe nga organi gjyqësor, porse ky i fundit nga vlerësimi i rrethanave në përmbushje të kriterëve ligjore që kërkon neni 59 i Kodit Penal, në ndryshim nga subjekti ka disponuar me një masë më të lehtë se ajo e kërkuar prej tij.*

42.1. Komisioneri Publik, në ankim, ndryshe nga sa ka arritur në përfundim Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke u bazuar vetëm në rrethanat që lidhen kryesisht me të pandehurin, duke mos vlerësuar:

(iv) shkallën e pakujdesisë së autorit të veprës penale, nga ku rezulton se aksidenti ka ardhur për shkak se drejtuesi i mjetit ka lëvizur me shpejtësi 161.6 km/orë, nga 80 km/orë që ka qenë shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor; dhe

(v) pasojën shoqërisht të rrezikshme, vdekjen e shtetasit P. B.

Për sa më sipër, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në aftësinë e prokurorit për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

³⁶ Evidentuar si çështje nga Komisioni, pas verifikimit të Raportit të KLP-së, për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj, nr. {***} prot., datë 10.07.2023, të rubrikës “Të dhëna nga burimet arkivore”, sipas të cilit: me shkresën nr. {***} prot., datë 17.02.2021, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar informacion në lidhje me subjektin e rivlerësimit, nga ka rezultuar se: me Urdhrin nr. {***}, datë 03.12.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj është pezulluar nga detyra, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. {***}/2015, për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal në ngarkim të Petrit Vukaj etj. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, me vendimin nr. {***}, datë 28.12.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. {***}, datë 27.10.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe pushimin e çështjes për të pandehurin Petrit Vukaj. Pas vendimit të pushimit të çështjes nga gjykata, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin nr. {***}, datë 16.01.2017, “Për revokimin e urdhrin nr. {***}, datë 03.12.2015, dhe rikthimin në detyrën e prokurorit”, për subjektin e rivlerësimit Petrit Vukaj.

³⁷ Paragrafi 42.9.13 i vendimit të Komisionit.

42.2. Përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, konfirmoi qëndrimin e Komisionerit Publik si më sipër, duke vlerësuar se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin e pezullimit të procedimit penal, tregon për mangësi profesionale, sipas parashikimit të nenit 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016.

42.3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, prapësoi se aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal nuk kushtëzohet nga ekzistenca kumulative e të gjitha rrethanave të parashikuara në këtë dispozitë. Sipas subjektit të rivlerësimit, ligji kërkon që, për sa kohë masa e dënimit që kërkohet ose jepet është deri në 5 vjet, të provohet ekzistenca e qoftë edhe njëjës prej rrethanave ligjore, të cilat janë të pavarura nga njëra-tjetra. Kjo logjikë ligjore është ndjekur prej tij në diskutimin përfundimtar në gjykimin e çështjes. Fakti që Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit kanë vlerësuar ndryshe nga kërkesa e organit të akuzës, duke mos aplikuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit, sipas subjektit, nuk mund të interpretohet si mangësi profesionale e prokurorit.

43. Në vlerësim të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik dhe pretendimeve të përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues vëren se neni 59 i Kodit Penal, në fuqi në kohën e trajtimit të procedimit penal nga subjekti i rivlerësimit, parashikonte se: *Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.*

Referuar vendimmarrjeve të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë³⁸, në praktikën gjyqësore rezulton një qëndrim i qartë dhe i konsoliduar rreth mënyrës së zbatimit të këtij parashikimi, sipas të cilit është evidentuar se në mënyrë që të aplikohet kjo dispozitë nga gjykata, duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet si më poshtë vijon:

Së pari: Të ekzistojë një prej kushteve të renditur në pjesën e parë të paragrafit të parë të kësaj dispozite, si: rrezikshmëria e paktë e autorit të veprës penale, mosha e të gjykuarit, kushtet shëndetësore apo mendore të tij, mënyra e jetesës dhe nevojat që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, të cilët janë kushte alternative jokumulative. Pra, mjafton të evidentohet se ekziston njëri prej tyre së bashku me kushtin tjetër, të poshtërenditur.

Së dyti: Gjykata të ketë dhënë ndaj të pandehurit, në përfundim të gjykimit, një dënim jo më të lartë se pesë vjet burgim. Pra, ligjvënësi e ka lidhur zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal me masën e dënimit të dhënë nga gjykata [kur jep dënim me burg deri në pesë vjet] dhe jo me atë të parashikuar nga dispozita konkrete e pjesës së posaçme të Kodit Penal për të cilën është deklaruar fajtor i pandehuri.

³⁸ *Vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 28, datë 26.01.2012; nr. 91, datë 27.05.2015; nr. 151, datë 18.06.2014; nr. 206, datë 09.12.2015; nr. 77, datë 25.05.2011 dhe nr. 31, datë 05.02.2014.*

Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se, në mënyrë që të aplikohet në çdo rast konkret neni 59 i Kodit Penal, duhet të evidentohet ekzistenca e njërit prej kushteve alternative të renditur në pjesën e parë të fjalisë së parë të këtij neni dhe gjykata të ketë caktuar një dënim deri në pesë vjet burgim.

43.1. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, në diskutimet përfundimtare përpara gjykatës, në lidhje me masën e dënimit për të pandehurin E. XH., ka arsyetuar mbi rrethanat lehtësuese dhe rënduese që duhet të merren parasysh, të cilat sipas vlerësimit të tij janë: fakti i të mos qenët i dënuar më parë, qëndrimi pohues ndaj akuzës, pendimi i thellë, normalizimi i marrëdhënieve me familjarët e viktimës, si dhe fakti që është i martuar dhe me fëmijë të mitur. Subjekti i rivlerësimit, në arsyetim, nuk ka analizuar provat mbi të cilat ka mbështetur vlerësimin e tij, megjithëse këto prova gjenden të administruara në dosje. Nga verifikimi i dosjes së procedimit penal nr. {***}/2015, trupi gjykues vëren se gjatë hetimit janë administruar nga subjekti i rivlerësimit aktet si vijon: certifikatë elektronike, lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme, datë 10.04.2015, sipas së cilës shtetasi E. XH. është i padënuar; vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. {***} prot., datë 20.04.2015, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit shtetasi E. XH. është i padënuar; shkresa e kryetarit të Kryesisë së fshatit {***}, datë 27.04.2015, sipas të cilit familja e të pandehurit nuk ka qenë asnjëherë problematike në komunitet dhe se babai i të pandehurit ka probleme shëndetësore të cilat kërkojnë përkujdesje, si dhe nevojën e një shoqëruesi; deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2015, në të cilën bashkëshortja e viktimës znj. E. B., deklaron se i pandehuri nga ana e saj është i falur, pasi ai dhe bashkëshorti i saj kanë qenë miq dhe ajo personalisht është dakord që i pandehuri të lirohet; deklarata noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.04.2015, në të cilën vëllai i viktimës, z. K. B., deklaron se i pandehuri nga ana e tij është i falur, pasi ai dhe vëllai i tij kanë qenë miq dhe ai personalisht është dakord që i pandehuri të lirohet; procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, datë 15.05.2015, sipas të cilit shtetasi K. B. ka deklaruar se ai dhe viktimja P. B., e kanë mik familjeje shtetasin E. XH. dhe për këtë arsye ai dhe bashkëshortja e viktimës E. B. nuk kërkojnë që i pandehuri të ndiqet penalisht; procesverbal i pyetjes së të pandehurit E. XH., datë 15.05.2015, në të cilin ai shprehet se është i papunë, i martuar, me dy fëmijë të vegjël dhe ditën e ngjarjes nuk kishte konsumuar pije alkoolike, por për shkak të shpejtësisë kishte humbur kontrollin e mjetit dhe ishte i penduar për ngjarjen e ndodhur.

43.2. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar, gjithashtu, se në lidhje me masën e dënimit për të pandehurin E. XH., duhet të merret parasysh rrezikshmëria *mesatare* e veprës penale, pasi i pandehuri, duke vepruar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në Kodin Rrugor për qarkullimin e automjeteve, nga pakujdesia, ka dëmtuar shtetasin P. B. duke i shkaktuar vdekjen, e megjithëse nuk e ka dëshiruar këtë pasojë, mund të parashikonte mundësinë e ardhjes së saj, por me mendjelehtësi ka shpresuar në shmangien e saj.

Duke pasur në konsideratë parashikimin e nenit 59 të Kodit Penal, i cili veç të tjerash vendos si kriter edhe rrezikshmërinë relativisht të ulët/*të paktë* të autorit dhe të rrethanave të veprës penale, vërehet se subjekti i rivlerësimit, arsyetimin e tij e ka bazuar në rrethanat që lidhen me gjendjen e të pandehurit, duke shmangur tërësisht arsyetimin lidhur me rrethanat e kryerjes së veprës penale, të cilat kanë rezultuar nga akti i ekspertimit autoteknik, sipas të cilit: (i) aksidenti ka ardhur për shkak se drejtuesi i mjetit ka lëvizur me shpejtësi 161.6 km/orë nga 80 km/orë që ka qenë shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor, dhe se (ii) si pasojë e veprimeve të të pandehurit si më sipër, ka ardhur pasojja e rëndë e humbjes së jetës së shtetasit P. B.

Këto rrethana janë marrë në konsideratë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila me vendimin nr. {***}, datë 07.10.2015, nuk e ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, duke arsyetuar se: “Në shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale konkrete që është *mbi mesatare*, gjykata ka parasysh dhe mënyrën dhe mjetin që ka përdorur i pandehuri për kryerjen e tyre, por edhe pasojat konkrete që kanë ardhur. Rrezikshmëri shoqërore paraqet edhe vetë i pandehuri. Në shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të tij, që është *mesatare*, gjykata ka parasysh shkallën e intensitetit të veprimeve konkrete që ka kryer i pandehuri, qëndrimin thellësisht pendues që mban për veprimet e kryera, por edhe faktin se nuk ka qenë i dënuar më parë. Në llojin dhe masën e dënimit, që gjykata do të aplikojë ndaj të pandehurit ka parasysh, jo vetëm shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale konkrete dhe të të pandehurit, por edhe shkallën mesatare të fajit, i cili në rastin konkret është nga pakujdesia në formën e vetëbesimit të tepruar. Nga sa më sipër, gjykata çmon se aplikimi i një dënimi me burgim do të jetë plotësisht i justifikueshëm dhe do t’ia arrijë qëllimit të edukimit të të pandehurit, por edhe të personave të tjerë të lëkundshëm, me frymën e zbatimit të legjislacionit penal”.

Ky qëndrim është gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. {***}, datë 10.02.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

43.3. Nga analiza e rrethanave faktike si më sipër, trupi gjykues çmoi se, edhe pse ekzistonin disa nga kushtet e parashikuara nga neni 59 i Kodit Penal, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet për të pandehurin në çështjen objekt kontrolli, pasi, pengesë për aplikimin e saj bëhet rrezikshmëria e veprës penale konkrete dhe rrezikshmëria e të pandehurit, e vlerësuar si *mesatare* nga gjykata, por edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, rrezikshmëri e çmuar mbi standardin e përcaktuar nga dispozita si “rrezikshmëri e paktë e të pandehurit”. Për pasojë, u gjet i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në aftësinë e prokurorit për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, mangësi që duhen trajtuar në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht sa më sipër, në vlerësimin e përgjithshëm, trupi gjykues për problematikat e evidentuara në këtë çështje mbajti në konsideratë qëndrimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë³⁹, sipas të cilit, në mënyrë që të aplikohet në çdo rast konkret neni 59 i Kodit Penal, duhet të evidentohet ekzistenca e njërës prej kushteve alternative të renditur në pjesën e parë të fjalisë së parë të këtij neni, dhe gjykata të ketë caktuar një dënim deri në pesë vjet burgim.

44. Në konkluzion, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vlerësoi se problematikat e konstatuara në tri nga çështjet e analizuara si më sipër, nuk janë në atë masë që të konsiderohen si mangësi serioze, të tilla që të cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, apo të ndikojnë në procesin e rivlerësimit të subjektit Petrit Vukaj.
45. Trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve sa më sipër, arriti në përfundimin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive

³⁹ Vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 28, datë 26.01.2012; nr. 91, datë 27.05.2015; nr. 151, datë 18.06.2014; nr. 206, datë 09.12.2015; nr. 77, datë 25.05.2011 dhe nr. 31, datë 05.02.2014.

profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve, provave dhe legjislacionit të zbatueshëm.

46. Në përfundim, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin nr. 774, datë 14.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj, për pasojë, ai duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit 774, datë 14.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 05.02.2026.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi – kundër

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, anëtari i trupit gjykues, Sokol Çomo, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kam votuar për ndryshimin e vendimit nr. 774, datë 14.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj, dhe shkarkimin e tij nga detyra.
2. Duke pranuar situatën faktike të konstatuar në arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, do të ndalem në ato konkluzione të cilat, sipas pakicës, meritojnë një vlerësim të ndryshëm nga ato të shumicës, që përcakton edhe qëndrimin tim për votën *kundër*.
3. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, kam arritur në konkluzione të njëjta me shumicën e trupit gjykues dhe bazuar në të njëjtat argumente të treguara prej saj në arsyetimin e vendimit se:
 - 3.1. Për pasurinë “banesë dy kate”, në {***}, Fier, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaratimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, dhe në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e investimit të katit të parë dhe të shpenzimeve të tjera, në vitin 2008, në shumën (-) 841.502 lekë dhe, për pasojë, gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e të njëjtit ligj.
 - 3.2. Subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 559.230 lekë, për blerjen e automjetit tip “DaimlerChrysler”, në vitin 2009, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
 - 3.3. Subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 134.916 lekë, për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2016, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
4. Sa më sipër, ashtu si dhe shumica e trupit gjykues, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, kam arritur në përfundimin se mungesat e burimeve të ligjshme financiare, për ndërtimin e katit të parë të banesës dy kate, në {***}, Fier, në vitin 2008, për blerjen e automjetit, në vitin 2009, si dhe për përballimin e shpenzimeve të vitit 2016, janë në shumën totale (-) 1.535.648 lekë.
5. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, sipas së cilës, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, mungesa e sipërcituar e burimeve të ligjshme u konsiderua e pamjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kam çmuar se kjo mungesë duhet të konsiderohet në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
6. Për sa i përket kriterit të kontrollit të figurës, kam ndarë të njëjtin qëndrim si shumica e trupit gjykues, se në kushtet kur në konkluzionet përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme theksoi se shkaku i ankimit për kriterin e kontrollit të figurës u konsiderua i shëruar, ai mbeti jashtë objektit dhe kufijve të shqyrtimit të çështjes, e për pasojë, nuk iu nënshtroa vlerësimit përfundimtar.
7. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, kam arritur në konkluzione të njëjta me shumicën e trupit gjykues, si vijon:

- 7.1. Për kallëzimin penal nr. {***}, të vitit 2015, me kallëzues A. A. dhe të kallëzuar R. A., për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Vetëgjyqësisë”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 150 dhe 277 të Kodit Penal, u gjet i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, në aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.
- 7.2. Për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2014, i regjistruar për veprat penale “Vrasje me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 278/4 të Kodit Penal, lidhur me vrasjen e shtetasit N. M. (B. RR.), subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi profesionale, në aspektin e njohurive ligjore dhe të arsytimit ligjor, sipas parashikimit të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.
- 7.3. Për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2015, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, e parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E. XH. i, u gjet i drejtë pretendimi i Komisionerit Publik dhe përfaqësuesit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në aftësinë e prokurorit për të interpretuar ligjin, kriter i parashikuar në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.
8. Në konkluzion, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, shumica ka vlerësuar se problematikat e konstatuara në tri nga çështjet e analizuara si më sipër, nuk janë në atë masë që të konsiderohen si mangësi serioze, të tilla që të cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë apo të ndikojnë në procesin e rivlerësimit të subjektit Petrit Vukaj.
9. Si gjyqtar në pakicë, në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, mangësitë e konstatuara më sipër nuk i kam konsideruar si të mjaftueshme për t’u kualifikuar sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por kam çmuar se duhet të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes për shkak të peshës së veçantë të problematikave të konstatuara në to, si vijon:
- 9.1. Për kallëzimin penal nr. {***}, të vitit 2015, me kallëzues A. A. dhe të kallëzuar R. A., për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Vetëgjyqësisë”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 150 dhe 277 të Kodit Penal, veprimet verifikuese të kryera nga subjekti i rivlerësimit nuk ishin të mjaftueshme për të kuptuar natyrën e faktit, për të cilin kallëzuesi ka pretenduar se përbënte fakt penal, në përputhje me vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Këto mosveprime të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të verifikimit të plotë të çështjes, duket se kanë favorizuar të kallëzuarit.
- 9.2. Për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2014, i regjistruar për veprat penale “Vrasje me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 278/4 të Kodit Penal, lidhur me vrasjen e shtetasit N. M. (B. RR.), shmangia nga subjekti i rivlerësimit e veprimeve hetimore të konsideruara të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të çështjes, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, ka sjellë si pasojë moszbardhjen e së vërtetës e mosgjetjen e autorëve të veprës penale, duke treguar dështim të organit

të prokurorisë, të përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit, për të çuar deri në fund ndjekjen penale në kundërshtim me qëllimin për të cilin ushtrohen funksionet e prokurorit.

- 9.3. Për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2015, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, e parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E. XH., subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar gjykatës zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal, edhe pse nuk kanë qenë kushtet për aplikimin e saj, në raport me rrezikshmërinë e veprës penale konkrete dhe rrezikshmërinë e të pandehurit, ku si pasojë e rrethanave të kryerjes së veprës penale, të cilat kanë rezultuar nga akti i ekspertimit autoteknik, aksidenti ka ardhur për shkak se drejtuesi i mjetit ka lëvizur me shpejtësi 161.6 km/orë nga 80 km/orë, që ka qenë shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor dhe, si pasojë e veprimeve të të pandehurit si më sipër, ka ardhur pasoja e rëndë e humbjes së jetës së një shtetasi. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit drejtuar gjykatës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, nuk është në përputhje me qëllimet e legjislacionit penal, i cili synon edukimin e të pandehurit dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale, si prej tij, ashtu edhe prej personave të tjerë, nëpërmjet nxitjes së respektimit të ligjit.
10. Kam vlerësuar se problematikat e mësipërme janë të një niveli të tillë, që konsiderohen serioze, e si të tilla përfaqësojnë mangësi të rëndësishme për njohuritë profesionale të subjektit të rivlerësimit, që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.
11. Problematikat e evidentuara për secilin procedim penal, në vlerësim të pakicës, pasqyrojnë një mënyrë sjelljeje dhe ushtrimi të detyrës së prokurorit, që nuk përputhet me standardet e pritshme të një magjistrati në administrimin e drejtësisë. Veçanërisht në çështje me ndikim në komunitetin ku ato janë kryer dhe ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën, këto problematika janë të natyrës së tillë, që cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
12. Në kushtet kur mangësitë e konstatuara në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale nuk janë të vetmet, por ato ekzistojnë krahas mungesës së burimit të ligjshëm të pasurive të subjektit të rivlerësimit, të cituara më lart, kam çmuar se ato duhen vlerësuar në tërësi, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një nga alternativat e vlerësimit të kriterëve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji. Në zbatim të këtij parashikimi, kam vlerësuar se, për shkak të ekzistencës së të gjitha këtyre problematikave, programi i trajnimit njëvjeçar në Shkollën e Magjistraturës nuk është i mjaftueshëm për të rikuperuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, kam çmuar të zbatueshëm, në këto kushte, parashikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.
13. Përfundimisht, kam arritur në konkluzionin se shkaqet e ankimit, për të cilat Komisioneri Publik dhe përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kërkuan ndryshimin e vendimit nr. 774, datë 14.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj, janë të mbështetura në prova dhe në ligj.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi